

RAPORT I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM
Për programin e studimit MSc në Informatikë Ekonomike

HYRJE

Skeda Informative e Universitetit Europian të Tiranës (UET)

Skeda informative e Universitetit Europian të Tiranës¹

EMRI I INSTITUCIONIT:	UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS (UET)	
Adresat:	Bulevardi Gjergj Fishta, Nd 70, H1, Tiranë	
	P.O. BOX	1023
	Tel:	+355 4 2421 806 +355 68 20 16 616
	Email:	info@uet.edu.al
	Web:	www.uet.edu.al
Licencuar:	VKM Nr. 636, Datë 20.09.2006 – licencuar si Shkollë e Lartë Universitare	
Statusi aktual ligjor:	VKM Nr. 657, Datë 28.09.2011 – emërtuar “Universiteti Europian i Tiranës”	
Përfaqësuesi zyrtar:	Prof. Asoc. Dr. Tonin Gjuraraj	Tel: +355 68 6077589
		Email: tonin.gjuraj@uet.edu.al
Struktura Akademike:	Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit	
	Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit	
	Fakulteti Juridik	
Oferta Akademike:	Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor)	
	Cikli i Dytë i Studimeve (Master i Shkencës, Master Profesional)	
	Cikli i Tretë i Studimeve (Doktoraturë)	
Akreditimi:	Akredituar si institucion me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Nr. 246, datë 24.07.2009 për Programet e Ciklit të Parë “Bachelor”. Akredituar me urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011 për Programet “Master i Shkencave”, “Master Profesional” dhe “Master i Niveli të Dytë”.	

Qëllimi dhe objektivat e raportit

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm (më poshtë do të quhet Raporti) është hartuar në përbushje të detyrimeve të Universitetit Europian të Tiranës për akreditimin e 7 programeve të Ciklit të Dytë dhe 2 programeve të Ciklit të Parë të studimeve që zhvillohen pranë dy prej fakulteteve të UET, përkatësisht pranë Fakultetit Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit (4 programe) dhe pranë Fakultetit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit (5 programe), që pasqyrohen në Tabelën më poshtë:

Tabela 1: Programet për të cilat kërkohet akreditimi

Fakulteti i Ekonomisë dhe i Teknologjisë së Informacionit	
Cikli i Dytë – Master i Shkencave (MSH)	
Programi	Profili
1. Informatikë Ekonomike	a. Administrim Biznesi
	b. Financë & Banka
Cikli i Dytë – Master Profesional (MP)	
2. Informatikë e aplikuar	a. Dezinjim dhe Zhvillim Aplikimesh
	b. Bazë të Dhënash

¹ Informacion i detajuar mbi aktet ligjore, personelin akademik, strukturën organizative dhe të dhëna statistikore mbi UET-in jepet në ANEKS-in e këtij dokumenti.

	c. Informatikë Sociale
3. Qeverisje e korporatave	
Cikli i Parë – Bachelor (BA)	
4. Informatikë Ekonomike	a. Menaxhim Biznesi
	b. Financë & Banka
Fakulteti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit	
Cikli i Dytë – Master i Shkencave (MSH)	
5. Shkencat e Edukimit	a. Politikat e edukimit
	b. Administrim Shkollor
6. Psikologji	a. Psikologji Këshillimi
	b. Psikologji Shkollore
Cikli i Dytë – Master Profesional (MP)	
7. Mësuesi	
8. Psikologji Shkollore	
Cikli i Parë – Bachelor (BA)	
9. Psikologji	

Raporti është përgatitur nga një Grup ekspertësh (më poshtë do të quhet Grupi) i ngritur posaçërisht për hartimin e tij me Urdhër të Presidentit të UET-it². Grupi është ngritur në përputhje me dispozitat ligjore si dhe me Udhëzimin e miratuar nga Senati i UET-it i datës 02.03.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe organizimin e sistemit të vlerësimit të brendshëm”.³

Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit është mbajtur parasysh kompetenca e tyre profesionale, aftësitë analizuese, mundësitë për mbledhjen dhe për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm, shkallën e nevojshme të njohjes, si dhe reputacionin e anëtarëve të Grupit.

Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në konsultim me personelin akademik dhe studentë, anëtarët e Grupit në analizën e tyre kanë vënë theksin në përmbajtjen akademike të Programeve që i nënshtrohen akreditimit, performancën e personelit akademik përgjegjës për realizimin e tyre; në vlerësimin e infrastrukturës dhe mjedisit në dispozicion, si dhe kanë evidentuar parametra të tjerë me rëndësi për procesin e akreditimit.

Grupi është bazuar në kërkesat e Ligjit mbi Arsimin e Lartë, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë udhëzimet e APAAL-it, si edhe ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të UET-it.

Grupit i janë vënë në dispozicion dhe ka shfrytëzuar në mënyrë racionale të dhënat statistikore që nevojiten për procesin e akreditimit, të cilat të strukturuar në formën e tabelave dhe grafikëve janë përfshirë në Raport.

Raporti përmban tre pjesë themelore dhe Aneksin përkatës me informacionin mbështetës dhe sqarues. E përbashkëta e tre kapitujve është skeda prezantuese, e formuluar mbi bazën e tabelave, përmbledhëse dhe përfaqësuese për UET-in dhe të dy fakulteteve, programet e të cilëve i nënshtrohen këtij vlerësimi.

Në pjesën e parë është bërë një paraqitje përshkuese dhe statistikore e Universitetit European të Tiranës, misioni, baza ligjore dhe institucionale, struktura organizative dhe e administrimit të UET-it, disa të dhëna të përgjithshme statistikore, arritjet e UET-it dhe strategjitë e zhvillimit të tij.

Pjesa e dytë ka në fokus vlerësimin e Programeve të Fakultetit Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit. Kjo pjesë fillon me skedën përfaqësuese, me një përshkrim të historikut dhe sfidave të këtij fakulteti dhe vazhdon më tej me vlerësimin e programeve specifike.

² Urdhri jepet në Aneksin bashkëngjitur këtij Raporti

³ Shih në dokumentet mbështetës bashkëngjitur këtij Raporti

Pjesa e tretë ka në fokus vlerësimin e Programeve të Fakultetit të Shkencave Sociale dhe Edukimit. Fillon edhe ajo me skedën përfaqësuese të fakultetit, me një përshkrim të historikut dhe sfidave të këtij fakulteti dhe në vazhdim jepet mendimi i ekspertëve dhe vlerësimi nga ata i programeve specifike.

Në mbështetje të Raportit është përgatitur Dosja e Vlerësimit të Brendshëm (më poshtë do të quhet Dosja), në përbërje të së cilës vend qendror zë Raporti i Vlerësimit të Brendshëm. Në përmbajtjen e Dosjes përfshihet edhe dokumentacioni në mbështetje të vlerësimit.

Misioni i UET

UET-i është ndërtuar dhe funksionon në përputhje me kërkesat e "Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", detyrimeve të procesit të Bolonjës dhe sfidave të garantimit të cilësisë në çdo hallkë e aktivitet të tij. Në realizim të këtij qëllimi, vizioni i UET-it ka synuar një universitet lider për zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare, një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve, një qendër ekspertize të specializuar në fushën e studimeve shoqërore-politike, ekonomike e juridike në vend, me ndikim në rajon e më gjerë; si dhe një qendër ekselence për kërkimin shkencor në ato drejtime specifike ku zotëron potencial si institucion i mirëfillt shkencor.

Baza ligjore dhe institucionale

UET-i e ushtron aktivitetin e tij bazuar në Ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë," i ndryshuar me Ligjin Nr. 10307, Datë 22.07.2010 si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit, Rregullores Bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatorë të institucionit.

UET-i fillimisht u krijua si Shkollë e Lartë Universitare Private me Vendimin Nr. 636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Europian i Tiranës si dhe të Programeve të Studimit të Ciklit të Parë. Në vijim të aktivitetit të tij, UET është akredituar me urdhër të Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009 ndërsa me urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011, UET-i është akredituar për Programet "Master i Shkencave" dhe "Master i Nivelit të Dytë".

Bazuar në urdhrin Nr. 503, Datë 07.10.2011 të Ministrisë të Arsimit dhe të Shkencës, UET-i ka hapur Programet e Studimit të Ciklit të Tretë (studime të doktoratës) në "Shkenca Ekonomike", "Shkenca Sociale" dhe "Shkenca Juridike". Me VKM nr. 657, datë 28.09.2011 emërtimi i institucionit është ndryshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti Europian i Tiranës, në "Universiteti Europian i Tiranës".⁴

Universiteti Europian i Tiranës është person juridik i njohur me Vendimin Nr. 36117, Datë 07.07.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndryshuar me Vendimin Nr. 36117/1, Datë 05.04.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i ndryshuar me Vendimin e Gjyqtarit të Vetëm, Nr. 36117/2, Datë 05.07.2007. Universiteti ushtron një veprimtari të pavarur ekonomike, e cila rregullohet nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Struktura organizative

Aktualisht, UET-i përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, të strukturuar në njësi bazë (departamente dhe qendra) të cilët paraqiten në Tabelën 2 më poshtë. Në strukturën e UET renditen edhe njësitë administrative e mbështetëse, si paraqiten në Tabelën 3. Një informacion më i detajuar është dhënë në organigramën e paraqitur në ANEKS-in bashkëlidhur këtij Raporti.

Gjatë viteve, struktura organizative e UET i është nënshtruar ndryshimeve dhe përmirësimeve, ndër të cilat spikasin ato që lidhen me fuqizimin e veprimtarisë së pavarur të departamenteve, forcimin e rolit koordinues në nivel fakulteti si dhe përmirësimin e administrimit dhe strukturën organizative të universitetit.

Tabela 2. Struktura e Fakulteteve të UET

FAKULTETI	DEPARTAMENTI/QËNDRA
Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit	Departamenti Financës
	Departamenti i Menaxhimit dhe Ekonomiksit
	Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës
Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit	Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun
	Departamenti i Shkencave Politike dhe Marrëdhënieve

⁴ Të dhëna të plota mbi bazën ligjore, licencimin dhe akreditimin e Programeve të Studimit paraqiten në ANEKS-in e këtij dokumenti.

FAKULTETI	DEPARTAMENTI/QËNDRA
	Ndërkombëtare
	Departamenti i Edukimit
Fakulteti Juridik	Departamenti i të Drejtës Private
	Departamenti i të Drejtës Publike
	Qendra e Studimeve Ligjore

Në këtë kuadër, u ristrukturuar qendrat e kërkimit, në të kaluarën nga një për çdo fakultet, të cilat pushuan së qeni njësi bazë të përhershme dhe u konceptuan si grupe kërkimore *ad hoc*, në rast të ndërmarrjes së projekteve kërkimore të caktuara.

Personeli përkatës akademik i Fakulteteve u riorganizua nëpër departamentet ekzistuese dhe departamentet e reja që u krijuan. Roli i departamenteve u fuqizua dhe kompetencat e tyre u zgjeruan, në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë; u forcua roli i Grup-lëndës si qeliza më e vogël e kompetencës akademike, si dhe u rrit roli i Këshillit të Fakultetit si organ kolegjal vendimmarrës; funksione ju dhanë edhe Këshillit të Departamentit si organ kolegjal këshillimor në nivel departamenti.

Gjithashtu, në strukturën organizative të UET-it u krijuan apo fuqizuan një varg njësisish të reja si Zyra e Projekteve për Kërkim e Zhvillim, Zyra e Teknologjisë së Informacionit si dhe filloi nga funksionet një pozicion i ri, ai i *Dekanit të Studentëve*, përgjegjës i Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit, funksion me rëndësi thelbësore në shërbim të garantimit të suksesit dhe mbështetjes së studentëve gjatë studimeve në UET, që njëherazi krijon mundësi edhe për aktivizimin e studentëve, që ata të shfaqin dhe të zhvillojnë tërë aftësitë dhe talentin e tyre.

Tabela 3. Njësitë administrative të UET

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	Zyra e Burimeve Njerëzore
2	Sekretaria Mësimore
3	Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave
4	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit
5	Zyra e Karrierës dhe e Praktikave
6	Zyra e Marrëdhënieve Publike dhe e Marketingut
7	Zyra e Financës
8	Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikës
9	Zyra e Koordinimit të Shkollës Doktorale
10	Zyra e Projekteve për Kërkim e Zhvillim
11	Qendra e Teknologjisë së Informacionit (Zyra e IT-së)

Një ndryshim me rëndësi në përputhje me misionin dhe objektivat e UET-it ishte fuqizimi i kërkimit shkencor; përcaktimi qartë i drejtimeve kryesore të kërkimit në nivel departamenti e më gjerë në shkallë universiteti si dhe krijimi i strukturave mbështetëse në këtë drejtim. Në këtë kuadër, për të mbështetur kërkimin shkencor, veçanërisht përfshirjen më të gjerë në projekte madhore të financuara nga burime të brendshme dhe ndërkombëtare, është krijuar Zyra e Projekteve të Kërkimit dhe Zhvillimit.

Disa të dhëna statistikore bazë

Gjatë vitit akademik 2011–2012, në dy ciklet e para të studimit, studimet në UET i ndjekin 3,151 studentë, ndër të cilët 2,147 në Ciklin e Parë, 679 në Ciklin e Dytë (MSH) dhe 325 po në Ciklin e Dytë (MP). Të dhënat e mësipërme dëshmojnë për një rritje të vazhdueshme të numrit të studentëve që nga fillimet e universitetit, njëherazi shprehin edhe rritjen e interesit për të studiuar në UET, për larinë e profileve që UET-i ofron, cilësinë e zhvillimit të veprimtarive akademike dhe mundësive të tjera që ofrohen në një mjedis bashkëkohor.

Lidhur me programet e studimit, UET-i ofron 13 programe studimi të Ciklit të Parë (BA), 12 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 13 programe të Ciklit të Dytë Master Profesional (MP) dhe 3 programeve të Ciklit të Tretë (Doktoraturë). Në mënyrë të detajuar të dhënat mbi studentët që kanë ndjekur të tre fakultetet e UET-it gjatë viteve akademike që nga themelimi i tij si institucion (pa përfshirë programet e doktoratës në vitin e fundit) janë paraqitur në Tabelën 4.

Aktiviteti akademik përballohet nga 148 pedagogë të angazhuar në UET, nga të cilët 73 të brendshëm dhe 75 të jashtëm; të ndihmuar nga 33 punonjës të strukturave administrative.

Tabela 4. Shërndarja e studentëve të regjistruar sipas fakulteteve dhe viteve akademike

FAKULTETI	STUDENTË					
	2006 – 07	2007 – 08	2008 – 09	2009 – 10	2010 – 11	2011 – 12
Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit	-	74	407	888	633	623
Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit	114	161	233	350	285	311
Fakulteti Juridik	61	179	197	456	269	296
Totali	175	414	765	1,694	1,187	1,230

Realizime dhe arritje

Në realizim të misionit të tij, UET-i ka qenë i fokusuar dhe do të vazhdojë të përqendrohet edhe në të ardhmen në disa shtylla kryesore si:

- Sigurimi i cilësisë akademike;
- Përqasja e programeve me kuadrin kombëtar të kualifikimit
- Rritja e investimeve për inovacion dhe punë kërkimore shkencore;
- Përqasja sociale, në atë që UET-i beson se është i aftë që të japë një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit.

Në kuadër të rritjes dhe zgjerimit të veprimtarisë akademike një kujdes i veçantë i është kushtuar rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe proceseve të mësimnxënies si dhe nxitjes së kërkimit shkencor afatgjatë, ndryshe të mësuarin gjatë gjithë jetës.

Në këtë kuadër universiteti ka arritur që të zhvillojë më tej dijet e studentëve dhe aftësitë e tyre për të komunikuar dhe zgjidhur problemet sipas qasjeve analizuuese dhe krijuese, si dhe duke u bazuar në gjykime të pavarura dhe duke menduar në mënyrë kritike. Realizimit të këtij synimi i ka shërbyer zhvillimi i njohurive dhe dijeve të studentëve me anë të praktikës dhe reflektimeve rreth tyre, proceseve eksperimentuese, aktiviteteve dhe detyrave domethënëse nga ana mësimore. Kujdes në rritje i është kushtuar kërkimit shkencor, përdorimit të teknologjisë bashkëkohore dhe zgjerimit e thellimit të njohurive mbi teknologjinë e informacionit dhe gjuhën angleze.

Lidhur me cilësinë, UET-i vlerësoi drejt dhe iu bashkua procesit të renditjes së universiteteve që u organizua e drejtua nga MASH dhe APAAL, në bashkëpunim me kompaninë gjermane CHE. Mbi procesin u informua hollësisht personeli akademik, ai ndihmës mësimor dhe studentët e UET-it. Njëherazi, UET i ofroi institucioneve vlerësuese me transparencë, korrektësi dhe në afatet e përcaktuara kohore të dhënat e kërkuara për procesin e renditjes.

Analiza e këtyre të dhënave nga kompania gjermane dëshmoi kujdesin e vazhdueshëm të UET në drejtim të plotësisht të standardeve të cilësisë, synimit për të pasur një personel të kualifikuar akademik, një personel administrativ të aftë e të përkushtuar, si edhe një infrastrukturë bashkëkohore të mbështetur me teknologji të avancuar. Në sajë të punës së kryer dhe arritjeve konkrete, UET-i u rendit në nivele të larta të vlerësimit për tërë programet e studimit që ofron në të tre fakultetet e tij.

Një tjetër faktor suksesi është lidhur me një punë të studiuar për të pasur një baraspeshim të angazhimeve të personelit akademik dhe kërkesave për një performancë cilësore, duke i kushtuar kujdes ngarkesës akademike për secilin pedagog. Në UET, ngarkesa e personelit akademik përfshin 4 lloje veprimtarish: mësimdhënien (së bashku me kualifikimin e vazhdueshëm profesional), kërkimin shkencor, shkëmbimin e njohurive dhe shërbimeve teknologjike dhe detyrat administrative.

Rëndësi i është dhënë edhe zhvillimit të personelit me anë të kualifikimeve jashtë vendit, kurseve afatshkurtra dhe afatgjata për metodat e mësimdhënies, marrjes parasysh të kërkesave të studentëve, si dhe duke zhvilluar akoma më shumë kriteret e promovimit profesional.

UET në mënyrë të përhershme ka qenë i ndërgjegjshëm për nevojat e vendit për të pasur qytetarë të formuar dhe të edukuar mirë dhe për një forcë pune më të aftë, në shërbim të ndërtimit të një shoqërie të së ardhmes, të bazuar në ekonominë e dijeve.

Meriton të veçojmë e theksojmë faktin se UET aktualisht ofron programe studimi në të tre ciklet: Bachelor (BA), Master i Shkencës (MSH) dhe Master Profesional (MP) si dhe në ciklin e tretë (Studime të Doktoraturës). Për të tre këto cikle, programet e studimit janë ndërtuar duke marrë parasysh si kërkesat e tregut të punës, ashtu dhe interesat e vetë studentëve. Këto programe janë hartuar dhe përshtatur për të ndikuar në të ardhmen e tregut të punës në Shqipëri dhe për të bërë diferencën me institucionet e tjera të arsimit të lartë. Në punën e tij të përditshme UET ka kontribuar ndjeshëm edhe për zhvillimin e shoqërisë dhe promovimin e standardeve të demokracisë nëpërmjet edukimit të

studentëve për një jetë qytetare aktive si dhe zhvillimit ekonomik të vendit dhe të rajonit të Ballkanit Perëndimor nëpërmjet formimit të një force pune të kualifikuar. Kjo është realizuar duke bërë një analizë rigoroze të gjendjes aktuale të vendit dhe përmbushjes së aspiratave të brezit të ri për zhvillim social dhe ekonomik.

Përmbushjes së këtij synimi i kanë shërbyer organizimi i aktiviteteve të rëndësishme në bashkëpunim me universitete apo institucione të tjera publike apo private të vendit dhe të huaja si brenda edhe jashtë vendit. Kërkimet shkencore, seminarët, projektet e ndërmarra dhe konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare kanë qenë të fokusuar në çështjet e demokracisë, zhvillimit të shkencave sociale, reformave juridike, demokratizimit të partive politike, zgjidhjeve të konflikteve, zhvillimit ekonomik të vendit dhe të rajonit, trashëgimisë kulturore dhe historike etj.

Objektivat strategjikë të UET-it

Duke mbajtur mirë parasysh kërkesat në rritje në fushën e arsimit të lartë, zhvillimet bashkëkohore në këtë drejtim, kërkesat në rritje për cilësi në procesin akademik, në kërkimin shkencor, në infrastrukturë dhe të parametrave të tjerë vlerësues, UET ka përcaktuar një varg objektivash strategjikë mbi të cilat janë ngritur Programet e Studimit, përfshirë edhe programet që i nënshtrohen këtij vlerësimi, si më poshtë.

- a. Arritja e ekselencës në të gjitha fushat e aktiviteteve akademike dhe të kërkimit;
- b. Garantimi i cilësisë në zhvillimin e programeve të studimit për të tre ciklet;
- c. Mbajtja e një personeli akademik cilësor, që zotëron vlerat dhe aftësitë më të larta profesionale;
- d. Pajisja e studentëve të diplomuar me edukimin më të mirë dhe mundësi që ata të rrisnin dijet, aftësitë dhe eksperiencën e tyre të vlefshme;
- e. Ndërtimi i urave të bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;
- f. Krijimi i një mjedisi nxitës e zhvillues për personelin akademik, punonjësit dhe studentët;
- g. Sigurimi i një mjedisi të qëndrueshëm që mundëson arritje cilësore në tërë zhvillimet akademike;
- h. Sigurimi i përkushtimit dhe përgjegjshmërisë në tërë veprimtaritë akademike e administrative.

GRUPI I VLERËSIMIT TË BRENDSHËM (GVB)

Përbërja e GVB:

1. Elda Papa – kryetar
2. Tamara Luarasi – anëtar
3. Magdalena Bregasi– anëtar
4. Valier Peshkëpia – anëtar
5. Marsel Cara – anëtar
6. Marinela Seitaj - anëtar

Shënim: Grupi i vlerësimit të brendshëm ngrihet nën përgjegjësinë e titullarit të njësisë, pasi ky i fundit merr mendimin e organit vendimmarrës përkatës. Në përzgjedhjen e anëtarëve të GVB duhen patur parasysh kompetencat profesionale, paanshmëria, mundësitë për grumbullimin e informacionit për të kryer vlerësimin dhe shkallën e nevojshme të njohjes të anëtarëve të grupit, përfaqësimit në grup të sa më shumë opinionëve të njësisë duke evituar në maksimum përfshirjen në të, të personave konfliktualë ose koniunkturalë. Grupi, si rregull ka në përbërje të tij 3-5 punonjës të njësisë. Grupi ngrihet qëllimisht për misionin e vlerësimit (grup ad hoc). Ai përcakton një strukturë organizative (drejtuesi, sekretari etj.) dhe një shpërndarje të detyrave. Është e domosdoshme që në GVB të përfshihen dhe përfaqësues të studentëve.

PROGRAMI I STUDIMEVE, ADMINISTRIMI NË SHËRBIM TË MISIONIT TË NJËSISË

1. Misioni dhe Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e programit të studimit, mësimdhënia dhe kërkimi shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektiveve dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për programin e studimit (historiku, numri i punonjësve në vite, numri i studentëve në vite, vendi i Programit të studimit në kuadrin kombëtar e ndërkombëtar.

Qëllimi i programit Master i Shkencave me 120 kredite është të përgatisë specialistë IT-je, por me njohuri edhe nga fusha e Ekonomisë. Për sa i përket fushës së teknologjisë së informacionit, studenti merr njohuritë e nevojshme për të qenë i aftë të bëjë një analizë të hollësishme të informacionit në biznesit e tij, të strukturojë informacionin në baza të dhënash dhe të realizojë aplikime për shfrytëzimin e bazave të të dhënave, ku fokusimi është kryesisht në aplikimet në Web.

Në sajë të njohurive të fituara, studenti do të jetë në gjendje të planifikojë punët e tij në rrjetat kompjuterike dhe do të dijë t'i administrojë ato. Sot, të fituarit e mjeshtërisë së programimit (ne rastin e këtij Masteri në gjuhën e programimit Java), është një përparësi e madhe për studentin në lidhje me tregun e punës, pasi ai mund të jetë pjesëtar i një projekti ku shtrohet një problem për zgjidhje (analizë e problemi), një programues i thjeshtë, ose një administrues i informacionit në kompjuter.

Në të njëjtën kohë ai do të jetë i aftë që njohuritë teknike t'i adaptojë për zgjidhjen e problemeve ekonomike në veçanti. Kështu një student që mbaron një Master të Shkencës në Informatikën Ekonomike dhe ka profilin Financë Bankë do të jetë në gjendje të përballojë aspektet që lidhen me informatikën për probleme të financës dhe ai që ka profilin Administrim Biznesi do të dijë të përballojë këtë aspekt në probleme të menaxhimit. Programi ofrohet me dy profile bazë ekonomike: Administrim Biznesi dhe Financë-Bankë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi sipas standardit/ kriterit ⁵
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.		
Kriteri 3	Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Ky program i ri studimi përbën një arritje cilësore për objektivat akademike të Fakultetit. Ky program merr përsipër të formojnë ekonomistë në drejtime të reja profesionale, shumë të kërkuara nga tregu i punës. Thëksojmë se programet në fushën e Informatikës Ekonomike dhe Informatikës së Aplikuar janë një risi në ofertën akademike të Universiteteve shqiptare, pasi janë drejtime shumë të kërkuara nga tregu i punës.
Kriteri 4	Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5	Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6	Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të		

⁵ GVB duhet të shprehen me shkrim për të gjitha kriteret. Në fund të kriterëve duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

institucionit.		
Kriteri 1	Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi përputhet më së miri me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Fusha e studimit, Informatika ekonomike, përkon me një nga drejtimet e mëdha të kërkimit shkencor në UET.
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kriteri 1 Kriteri 2	Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi; Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.	Përmbajtja e programit dhe objektivat që synohet të arrihen në përfundim të tij janë plotësisht në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Emërtimi i programit është në përputhje me nivelin e e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.		
Kriteri 1 Kriteri 2	Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve; Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	Po UET ka hartuar një strategji 5 vjeçare të Mësimdhënies dhe të Përvetësimit të Dijeve. Gjithashtu UET ka hartuar dhe miratuar edhe Strategjinë e Kërkimit Shkencor në UET ku përcaktohen drejtimet kryesore për zhvillimin e institucionit në afatmesëm.
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Konstatohet se programi i studimit Msc. në Informatikë Ekonomike, është në përputhje me aktet ligjore e nënligjore, misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të UET, dhe kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë.		

2. Struktura akademike e Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Strukturat akademike të Fakultetit, ndarja në Departamente, të dhëna për ndarjen e personelit në këto njësi bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

Skeda Informative e Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit

FAKULTETI:	FAKULTETI I EKONOMISË DHE TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT	
Adresa:	Bulevardi Gjergj Fishta, Nd 70, H1, Tiranë	
	P.O. BOX	1023
	Tel:	+355 4 2421 806
	Mobile	+355 68 20 16 616
	Email:	info@uet.edu.al
	Web:	www.uet.edu.al
Dekani:	Prof. Dr. Luljeta Minxhozi	Mobile: +355 68 20 16023
		Email: luljeta.minxhozi@uet.edu.al
Struktura organizative	Departamenti i Financës	
	Departamenti i Menaxhimit dhe Ekonomiksit	
	Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës	
Oferta Akademike:	Cikli i Parë i Studimeve (Bachelor):	
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Financë Bankë 2. Menaxhim Biznesi 3. Informatikë ekonomike (Menaxhim biznesi) 4. Informatikë ekonomike (Financë & banka) 5. Marketing 	
	Cikli i Dytë i Studimeve – Master i Shkencës:	

	1. FINANCË BANKA: shoqëruar me një nga profilet: a. Banka dhe Tregje financiare b. Ekonomi – Financë 2. ADMINISTRIM BIZNESI: shoqëruar me një nga profilet: a. Biznes – Marketing b. Administrim publik c. Ekonomi Evropiane 3. INFORMATIKË EKONOMIKE, me profilet: a. Administrim biznesi b. Financë & Banka Cikli i Dytë i Studimeve – Master Profesional: 1. BANKA DHE SIGURIME; ose e shoqëruar me një nga profilet: a. Banka b. Sigurime c. Politika fiskale 2. MARKETING; ose e shoqëruar me një nga profilet: a. Shërbime dhe turizëm b. Inovacion dhe tregje strategjike c. Marketing bankar dhe financiar 3. MENAXHIM BIZNESI; ose e shoqëruar me një nga profilet: a. Menaxhimi i SME-ve b. Menaxhimi i burimeve njerëzore dhe karrierës c. Institucione dhe administrim publik 4. INFORMATIKË E APLIKUAR; ose e shoqëruar me një nga profilet: a. Dezinjim dhe Zhvillim Aplikimesh b. Bazë të dhënash c. Informatikë sociale 5. QEVERISJE E KORPORATAVE Cikli i Tretë i Studimeve (Doktoraturë): 1. SHKENCA EKONOMIKE, shoqëruar edhe me profilet: a. Financë b. Menaxhim c. Ekonomi dhe Zhvillimi i Qëndrueshëm d. Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit							
Numri i studentëve të regjistruar	2010 - 2011				2011 - 2012			
	BA	MSH	MP	Totali	BA	MSH	MP	Totali
	374	102	157	633	289	172	162	623

Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga tri Departamente: Departamenti i Menaxhimit dhe Ekonomisë, Departamenti i Financës dhe Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës. Secili nga departamentet ka në përbërjen e tij disa Grup-lëndë të cilat përgjigjen për përmbajtjen e lëndëve të përafërta.

Gjatë viteve të ekzistencës së tij, Fakulteti i është nënshtruar ndryshimeve të cilat kanë pasur për qëllim lidhjen më të mirë të programeve të studimit, të diplomave që ofrohen me mënyrën e organizimit të Departamenteve, me qëllim sigurimin e një cilësie sa më të mirë të programeve të studimit, në përgjigje të kërkesave të tregut.

Aktualisht, Fakulteti ofron 5 programe studimi të Ciklit të Parë (BA), nga të cilët njëri nuk është hapur; 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 5 programe të Ciklit të Dytë Master Profesional (MP) dhe 1 program të Ciklit të Tretë (Doktoraturë). Përballimi i kësaj detyre mundësohet përmes angazhimit të një personeli akademik të përbërë nga 63 pedagogë, nga të cilët 30 të brendshëm (18 me grada e tituj) dhe 33 të jashtëm.

Në këtë Fakultet ndjekin studimet 53% e studentëve të programeve Bachelor të UET-it, rreth 40% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master i Shkencave dhe 62% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master Profesional që ofron universiteti. Këto shifra janë edhe një indikator i qartë i interesit të madh për të studiuar në këtë fakultet, për larminë e profileve që ofrohen, cilësinë e zhvillimit të proceseve akademike dhe tërë mundësitë e tjera që siguron universiteti. Në mënyrë më të detajuar të dhënat mbi studentët e regjistruar gjatë dy viteve të fundit akademike janë paraqitur në Skedën informative mbi Fakultetin.

Programet e studimit të Ciklit të Dytë synojnë përgatitjen e ekonomistëve me njohuri të thelluara ekonomike duke filluar që nga aspektet financiare, aktivitetet kontabël të ndërmarrjeve, deri në menaxhimin dhe organizimin e punës në ndërmarrjet shtetërore dhe në ato private. Gjithashtu synohet përgatitja e ekonomistëve të specializuar në problemet

financiare, kontabël, banka, shoqëri sigurimesh, menaxherë të ndërmarrjeve dhe enteve publike, specialistë të marketingut në sektorët e shërbimeve në përgjithësi dhe atyre të bankave në veçanti, administratorë të rrjetave kompjuterike, analizues të bazave të të dhënave etj.; të cilët do të jenë të aftë të përmbushin detyrat dhe funksionet në pozicionet e financiarit të firmave dhe bizneseve të ndryshme, të ekspertit kontabël të niveleve të ndryshme, të punonjësve të bankave dhe shoqërive të sigurimit, të eksperteve dhe analistëve të tregjeve financiare, të punonjësve të degëve të tatim-taksave, sistemit doganor, etj.

Duke filluar nga viti akademik 2010–2011 në këtë Fakultet janë shtuar programet e studimit MSH në Informatikë Ekonomike dhe MP në Informatikë të Aplikuar, dhe është diversifikuar oferta në fushën e financës me një program të ri MP: Qeverisje e Korporatave. Edhe në Ciklin e Parë të studimeve është rritur oferta me dy programe të reja: Bachelor në Informatikë ekonomike (me dy profile) dhe Bachelor në Marketing. Ky i fundit megjithatë nuk është aktivizuar për mungesë interesi të studentëve.

Tregues të matshëm:

- Struktura akademike e Fakultetit (organigrama)
- Numri i personelit akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (shih Tabelën 1)

Tabela 1

Fakulteti i Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit	Departamenti i Financës							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
	8	3	10	1			18	4
	Departamenti i Menaxhimit dhe Ekonomiksit							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada
	15	9	13	4			28	13
	Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës							
	Numri i PAE		Numri i PAK		Numri i PA		Në Total	
Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	Gj	Tituj/Grada	
7	6	10	3			17	9	

Shënim: Personeli administrativ është në funksion të të gjithë institucionit dhe përbëhet nga 33 anëtarë.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (shih Tabelën 2)

Tabela 2

Emër Mbiemër	Titulli/grada	Pozicioni në Këshillin shkencor
Indrit Baholli	Dr.	Koordinator
Tamara Luarasi	Prof. Asoc. Dr.	Anëtare
Mimoza Durrësi	PhD	Anëtare

- Dokumentacioni përkatës

3. Personeli akademik dhe mbështetës

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin

akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e UET-it, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative, sipas përcaktimeve në Statutin e UET-it dhe Kontratës së lidhur mes tyre dhe UET-it.

Personeli akademik ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë është me kontratë me afat ose pa afat, dhe përbëhet nga drejtuesit, personeli akademik i brendshëm dhe pedagogët senior. Personeli akademik i punësuar me kohë të pjesshme përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të veçantë. Secili Departament pas një analize të hollësishme të kapaciteteve dhe ngarkesave konstaton nevojën për personel të ri akademik, paraqet propozimin për rekrutim personeli akademik në Këshillin e Fakultetit. Propozimi përmban profilin profesional të personelit akademik, që propozohet të rekrutohet, si dhe argumentimin e këtij propozimi, dhe në varësi të ngarkesës që pritet të mbulojë, nëse nevojitet pedagog i brendshëm ose i jashtëm.

Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave, janë treguesit e performancës së kandidatëve, të tillë si:

- Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar;
- Të ketë së paku gradë shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Profesor, Profesor i Asociuar, Akademik;
- Cilësia dhe standardet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore;
- Rezultatet personale të kandidatit;
- Aktiviteti kërkimor e botues dhe përputhshmëria e tij me objektivat shkencorë të UET-it;
- Motivet kryesore për t'u bërë pedagog në UET;
- Aftësitë komunikuese dhe etika;
- Objektivat e tij afatmesëm dhe afatgjatë në karrierën akademike e shkencore;
- Përvoja e punësimit dhe rekomandimet e punëdhënësve të mëparshëm;
- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre;
- Paraqitja gjatë intervistës nga komisioni i posaçëm i rekrutimit;
- Paraqitja gjatë leksionit të hapur para Departamentit përkatës (kur aplikohet).

Raste të veçanta: Përveç pedagogëve me tituj e grada, për nevoja të veçanta dhe për periudha të caktuara, në UET mund të punësohen edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesionin dhe institucionin e tyre, janë unikë në fushën e tyre të specializimit, etj. Marrja e tyre bëhet për të plotësuar kërkesa të veçanta të programit mësimor, të tilla si lëndë me karakter praktik, cikle specifike leksionesh dhe seminaresh, orësh praktike, etj.

Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe UET-it, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e UET-it, në rregulloret, në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Integritetit Akademik, si dhe në dokumentet e tjera të miratuara nga organet drejtuese të UET-it.

Tregues të matshëm:

- Cilësia e stafit drejtues, mësimdhënës dhe administrativ për çdo njësi (plotëso Tabelën

3)

Tabela 3

Fakulteti Ekonomik dhe IT - Departamenti i Financës							
PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli/ Grada	Institucioni ku punon full time
1	Elvin Meka	Përgjegjës	Dr.	1	Irena Beqiraj	CFA	Shoqëria Colombo II Sh.p.k
2	Magdalena Bregasi	Përgj. grup-lënde	Prof. Asoc.	2	Erjon Saraçi	ACCA	CEZ Albania sh.a.

3	Anilda Bozdo	Përgj. grup-lënde	Dr.	3	Teuta Baleta	MA	Autoriteti i Mbiqyqjes Financiare
4	Arbi Agalliu	Pedagog	Doktorant	4	Nuriona Sokoli	ACCA	Deloitte Albania shpk
5	Artan Gjergji	Pedagog	Doktorant	5	Holtjana Bello	Msc.	
6	Edmond Bello	Pedagog	MBA	6	Enkela Idrizi	MBA	
7	Ermela Kripa	Përgj. grup-lënde	Doktorant	7	Vjola Tarka	MND	
8	Mimoza Kaçi	Pedagoge	Doktorant	8	Laura Konda	Msc.	Grant Thornton Albania Shpk
				9	Selami Xhepa	Dr.	Kuvendi i Shqipërisë
				10	Mateo Spaho	MA	Ministria e Financave

Fakulteti Ekonomik dhe IT - Departamenti Menaxhim dhe Ekonomiks

PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli/ Grada	Institucioni ku punon full time
1	Adrian Civici	President	Prof. Dr.	1	Andia Puka	MA	
2	Luljeta Minxhozi	Dekane	Prof. Dr.	2	Ledia Thoma (Boshnjaku)	Dr.	Universiteti Bujqësor i Tiranës
3	Engjell Pere	Përgjegjës	Prof. Asoc.	3	Soana Teka	Dr.	Universiteti i Tiranës
4	Arjan Kadareja	Përgj. grup-lënde	PhD	4	Saimir Suma	MA	
5	Edlira Gjuraj	Pedagoge	Dr.	5	Drita Kruja	Dr.	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
6	Enea Zafiri	Pedagog	Doktorant	6	Manuela Meçe	Dr.	Oxfam GB, Shqipëri
7	Evis Gjebrea	Pedagoge	Doktorant	7	Besart Kadia	Msc.	Foncacioni zvicerian RRPP LCU - AL
8	Genti Beqiri	Pedagog	Doktorant	8	Besarta Vladi	MSh	
9	Herion Ndreka	Pedagog	Doktorant	9	Gavril Lasku	Doktorant	
10	Kreshnik Bello	Përgj. grup-lënde	Dr.	10	Irina Canco	Doktorant	Ministria e Financave
11	Nevila Xhindi	Pedagoge	Dr.	11	Rajmonda Avignon	MA	
12	Ermira Qosja	Përgj. grup-lënde	Dr.	12	Oliana Sula	MSh	
13	Arben Bakllamaja	Përgj. grup-lënde	Dr.	13	Metin Barxhaj	MND	Inspektoriati i Lartë i deklarimit dhe kontrollit të pasurive
14	Patris Poshnjari	Pedagoge	Doktorant				
15	Manol Simo	Pedagog	Doktorant				

Fakulteti Ekonomik & IT - Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës

PAE (Emër Mbiemër)		Detyra në Dep.	Titulli/ Grada	PAK (Emër Mbiemër)		Titulli/ Grada	Institucioni ku punon full time
1	Indrit Baholli	Përgjegjës	Dr.	1	Aleksandër Biberaj	Dr.	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Petra Papajorgji	Pedagog	Prof. Dr.	2	Elma Çela	Doktorant	Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
3	Tamara Luarasi	Përgj. grup-lënde	Prof. Asoc.	3	Tomi Thomo	MA	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
4	Aranit Shkurti	Përgj. grup-lënde	Dr.	4	Ani Sharko (Dasho)	MA	CEZ Albania sh.a.
5	Hysen Binjaku	Pedagog	Prof. Asoc.	5	Fatjon Seraj	Msc.	Freelancer IT
6	Teuta Xhindi	Pedagoge	MA	6	Avis Andoni	Msc.	-
7	Mimoza Durrësi	Pedagoge	PhD	7	Vasillaq Kedhi	Prof. Dr.	në pension
				8	Agim Kasaj	MBA	Ministria e Drejtësisë
				9	Aurora Binjaku	MND	Digitalb
				10	Elida Hoxha	Prof. Asoc.	Universiteti i Tiranës

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (plotëso Tabelën 4)

Tabela 4

Titulli	Departamenti i Financës			Departamenti i Menaxhimit dhe Ekonomiksit			Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesor	0	0		2	0	2:0	1	1	1:1
Profesor i Asociuar	1	0	1:0	1	0	1:0	2	1	2:1
(me PhD/Dr)	2	1	2:1	6	4	6:4	3	1	3:1
(pa PhD/Dr)	5	9	5:9	6	9	6:9	1	7	1:7

Të dhëna sipas moshës (plotëso Tabelën 5 dhe 6)

Tabela 5

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAE dhe PA me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	0	0	2	1	0
As. Prof	0	0	2	2	0
Doktorë	1	5	3	2	0
Pedagogë (pa Dr.)	7	4	1	0	0
Personeli Administrativ *	18	7	5	3	0

*Personeli administrativ është dhënë në nivel institucional pasi nuk është i ndarë sipas njësive kryesore.

Tabela 6

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i PAK me moshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë	0	0	0	0	1
As. Prof	0	0	1	0	0
Doktorë	1	3	2	0	0
Pedagogë (pa Dr.)	17	7	1	0	0

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.		
Kriteri 1	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;	Personeli akademik dhe administrativ është i informuar për objektivat e programeve të studimit dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, përmes një dokumentacioni të gjerë rregullator që është i publikuar në intranet, në një folder ku i gjithë personeli ka akses. Performanca kontrollohet vazhdimisht nga Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i cili bën edhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e kërkuar, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe aktet rregullatore në fuqi.
Kriteri 2	Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të		

zhvillimit të institucionit.		
Kriteri 1	Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;	Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njëjësive bazë, departamenteve. Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpara kolegëve ndryshimet e propozuara. Nëse vendimi miratohet në nivel departamenti kalon për miratim në instancat më të larta të Këshillit të Fakultetit e më pas në Senatin Akademik. Në rekrutimin e personelit akademik merret në konsideratë kërkesat ligjore dhe përcaktimeve në rregulloren e brendeshme. Kështu një pedagog nuk mund të zhvillojë më shumë se 4 lëndë në vit. Në programet e ciklit të dytë duhet të angazhohen pedagogë me grada dhe tituj.
Kriteri 2	Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.	
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.		
Kriteri 1	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;	UET i ka të përcaktuara në dokumentacionin bazë që rregullon veprimtarinë e institucionit, parimet, kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Sa i takon vlerësimin të performancës, pedagogët i nënshtrohen disa vlerësimeve gjatë vitit akademik: 1. vlerësimin nga përgjegjësi i departamentit; 2. vlerësimin nga studentët; 3. vlerësimin nga drejtuesit e UET në fund të vitit akademik (procesi follow-up) Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Arkivit gjenden gjenden dosje të aplikantëve për punë, të komisioneve të intervistimit, vlerësimin të kandidatëve dhe njoftimeve për punë.
Kriteri 2	Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;	
Kriteri 3	Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit; Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.	
Kriteri 4		
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.		

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p> <p>Kriteri 5</p>	<p>Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete; Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”; Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i programit të studimit ka gradën Doktor i Shkencave me përvojë edhe akademike edhe profesionale në këtë fushë. Të gjithë titullarët e lëndëve janë pedagogë me grada dhe tituj. Në lëndë opsionale janë angazhuar edhe dy asistentë në proces doktorature, nën drejtimin dhe kujdesin e pedagogëve me tituj. 70% e ngarkesës së programit është realizuar me pedagogë të brendshëm. Sa i takon personelit të jashtëm, vlen të theksojmë se të gjithë kanë mbi një vit që angazhohen në UET, gjë që dëshmon për qëndrueshmërinë e bashkëpunimit me institucionin, duke garantuar njohuri dhe përvetësim më të lartë edhe të rregullave dhe kërkesave specifike të UET-it.</p> <p>Raporti pedagogë/studentë është mjaft i ulët, rreth 1:1.2; çka mundëson një përkushtim mjaft të madh të personelit akademik ndaj studentëve të programit, dhe mbikëqyrje të mirë të praktikave profesionale.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p>	<p>Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi, gjatë vitit të dytë të studimeve përgatisin dhe mbrojnë një punim diplome. Udhëheqësi i tezave është gjithmonë një pedagog me gradë dhe/ose titull, i cili krahas takimeve të personalizuara, zhvillon edhe seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar një mbarëvajtje të procesit të shkrimit të punimit. Nga të dhënat që disponohen tek koordinatori e departamentit, vihet re se pedagogët udhëheqin një numër studentësh në përputhje me kriteret dhe standardet e vendosura.</p>
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e tezës master garanton që udhëheqësi i propozuar nga studenti të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar. Nëse nuk konstatohet përputhshmëri, atëherë Departamenti cakton një pedagog udhëheqës që i përmbush këto kriteret. Studentët njoftohen për listën e miratuar me temat dhe pedagogët udhëheqës. Nëse nuk ka pedagogë të brendshëm të përshtatshëm për të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë departamenti ka të drejtë të caktojë në pedagog të</p>

		jashtëm brenda kriterëve të kërkuara.
Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.		
Kriteri 1		<p>Stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimi. Gjithashtu personeli administrativ është gjithmonë në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p>Për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET funksionon Zyra e Karrierës dhe Praktikave, e cila ka lidhur memorandume bashkëpunimi me shumë institucione publike dhe kompani private, duke mbajtur komunikim të vazhdueshëm me ta, për të garantuar akomodimin e studentëve në këto institucione. Krahas rolit të kësaj zyre, studentëve u caktohet një pedagog mbikëqyrës, i cili ndjek zhvillimin korrekt të praktikës mësimore në institucionin pritës dhe jep vlerësimin e tij në përfundim të kryerjes së praktikës nga ana e studentit.</p>
Kriteri 2	<p>Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollorë; Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.		
Kriteri 1	<p>Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli i angazhuar në programet e ciklit të dytë realizon ngarkesën mësimore sias akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET-in. Si rregull pedagogët me grada e tituj duhet të plotësojnë ngarkesën fillimisht në ciklin e dytë dhe të tretë. Një orë fizike në auditor llogaritet 1.25 orë njësi për efekt ngarkese. Edhe proceset e tjera akademike si udhëheqjet e diplomave, oponencat, mbikëqyrjet e praktikave profesionale konvertohen në orë mësimore njësi.</p>
Kriteri 2		
Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.		
Kriteri 1	<p>Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Departamentet për programet dhe lëndët që menaxhojnë dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucional, mbajnë të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit, ngarkesën që mbulon.</p> <p>Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik përcaktohen me dokument të veçantë, pjesë e broshurës së dokumenteve UET dhe publikohen në faqen e internetit dhe media sa herë që ka shpallje të vendeve vakante.</p>
Kriteri 2		
Kriteri 3		

Konkluzionet e vlerësimit:

Grupi vlerëson se personeli akademik i angazhuar për drejtimin dhe zhvillimin e programit të studimit është brenda kritereve të përcaktuara, me grada dhe tituj, si edhe eksperiencë të gjatë në mësimdhënie. Rol të rëndësishëm në mbështetjen e mirëorganizimit të procesit mësimor ka edhe personeli administrativ. Personeli është i mirëinformuar për rregullat e institucionit dhe objektivat e misionin e tij. I gjithë dokumentacioni rregullues i UET-it, dhe aktet kryesore ligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit janë të publikuara në një folder të përbashkët, në intranet. UET ka të dhëna të detajuara sa i takon personelit akademik të angazhuar, forma e punësimit dhe ngarkesa e realizuar.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti Europian i Tiranës ndodhet me seli në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H1, Tiranë. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 10,000 m². Përreth godinave, ndodhet një hapësirë e gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rreth 120 makina.

Objekti është i pajisur me dy palë shkallë, nga të cilat, në rast emergjence në njërin krah të godinës, mundet të përdoret shkalla tjetër. Gjithshtu, godinat janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si vijon: një shuarse zjarri në çdo kat, dhe nga një shuarse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 12 copë, si edhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, përkatesisht rufe-pritëse.

Institucioni ka të garantuar burime alternative për furnizimin me energji elektrike që përbëhet nga motogenerator, si edhe ka të garantuar rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, të cilat realizohen nga rrjeri publik i ujit të pijshëm si dhe pus uji rezervë dhe system pompimi përkatës. Mjediset janë të kompletuara me sistemin e ngrohjes të tipit Fankoil, me komandim qëndror. Ky sistem funksionon pa ndërprerje dhe janë çertifikuar mirëmbajtje të rregullta të tij nga firma instaluese.

Tregues të matshëm:

Mjediset e fakultetit (plotëso Tabelën 7)

Tabela 7

Mjediset për Fakultetin/përgjegjës për programin e studimit	Sasia	Sipërfaqja
Salla për leksione	9	1160 m ² (1,215 vende)
Klasa për seminare	24	1200 m ² (840 vende)
Salla për aktivitete promovuese	2	180 m ² (150 vende)
Salla për praktikë lëndore/ profesionale		
Laboratorë për lëndët		
Laboratorë informatike	3	140 m ² (110 vende)
Salla interneti	1	160 m ² (80 vende)
Salla për bibliotekë	1	300 m ²
Mjedis për fotokopjime, librari etj	1	150 m ²
Zyrë informacioni për studentët	2	
Korridore/holle	8+2	
Mjedise sportive	-	
Mjedise shërbimi për të tretë	-	
Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore	2	100 m ²
Mjedise shlodhëse si kafeteri/ fast-food/etj	1	500 m ²
Nyje hidrosanitare për studentët	40	250 m ²
Etj....		
Norma m²/për student	4.6 m²/student	

Mjediset për stafin:	Sasia	Sipërfaqja
Zyra për Dekanin/zv dekanin/ kancelarin	8	300 m ²
Zyra për sekretarinë mësimore	8	250 m ²
Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore	9	360 m ²
Zyra për personelin akademik	25	400 m ²
Zyrë për financën	2	60 m ²
Zyrë për Njësinë e SBC	1	30 m ²
Salla për mbledhje	7	390 m ²
Mjedis për stafin e shërbimit	4	150 m ²
Nyje hidrosanitare për personelin akademik	8	55 m ²
Norma m²/për person	18.8 m ² /person	

Dokumentacioni përkatës (planimetritë)në Aneksin Nr..

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.		
Kriteri 1	Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	UET ndodhet në Blv. Gjergj Fishta që prej shtatorit 2007. Para dy vitesh infrastruktura e universitetit u dyfishua duke marrë në përdorim një godinë tjetër, identike me ekzistuesen. Kjo e bën infrastrukturën e UET-it të bollshme dhe shumë komode. Këto ambiente janë marrë me qera deri në fund të kësaj dekade. Gjithashtu për një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, mësimi në klikin e parë të studimeve zhvillohet nga e hëna në të premte, 9:00-16:00, ndërsa në programet e ciklit të dytë ditëve të javës nga ora 17:00 dhe të shtunave 9:00 – 16:00. Edhe mësimi për programet e ciklit të tretë të studimeve zhvillohet ditëve të premte pasdite dhe të shtunave.
Kriteri 2	Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	
Kriteri 3	Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	
Kriteri 4	Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.		

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p> <p>Kriteri 5</p>	<p>Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore; Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim; Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka disponon: 2852 tituj në shqip dhe 660 tituj gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, Italisht) tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse.</p> <p>Për realizimin e programeve biblioteka zoteron rreth 6044 tituj të disponueshëm për studentët. Biblioteka ka 150 vende leximi dhe 8 kompjutera për punime dhe kërkime shkencore.</p> <p>Botimet Periodike në shqip janë 122 tituj me numra të ndryshëm dhe 25 tituj të huaja (anglisht, frengjisht). Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencorë si: EBCSO, Emerald, Cambridge University, Taylor & Francis, Questia, Etj.</p> <p>Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: nga Hene-Premte 9:00-20:00 e Shtunë 9:00:17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p>	<p>Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit; Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 3 laboratorë mësimorë Informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC, video projektor. Lab 206 B me 35 PC, video projektor. Lab 207 B me 35 PC, video projektor. Lab 208 B me 80 pc (Laboratori i internetit). 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Biblioteka njëkohësisht është e paisur me pc në mënyrë që studentët të kenë mundësi të lexojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga UET. Ambientet universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin.</p> <p>Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen PC-te Projektoret dhe Sistemi i fonisë. Paisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Laboratorët e informatikë/satistikës janë paisur me softwarët përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire programit mësimor.</p> <p>Më konkretisht, sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, paketa Microsoft Office 2010 është instaluar e plotë me të gjithë softwarët e saj.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Access • Communicator • Excel • InfoPath

		<ul style="list-style-type: none">• OneNote• Outlook• PowerPoint• Publisher• SharePoint Workspace• Word <p>Ndërsa për programet e Informatikës së avancuar, statistikës dhe programit master në informatikë ekonomike janë instaluar programet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">• Navicat for my SQL• NetBeans• Apache Tom Cat• SPSS 19 <p>Të gjithë laboratorët janë të paisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin mjaft modern të procesit mësimor.</p> <p>Mirëmbajtja dhe azhurnimi i paisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit, instalimet e programeve dhe azhurnimet e tyre bëhen në kohë reale.</p> <p>Në të njëjtën kohë programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore.</p> <p>Nga 4 laboratorë kompjuterikë është caktuar që programi master në informatikë ekonomike të zhvillojë procesin mësimor tek laboratorit 205 B; Bazat e Informatikës të zhvillojnë procesin mësimor pranë laboratorit 207 B dhe 208 B; ndërsa Informatika e Avancuar dhe statistika pranë laboratorit 206 B.</p> <p>Kuptohet që këto laboratorë ashtu si edhe e përmendëm më lart u janë përshtatur programeve mësimore që zhvillohen në to.</p> <p>Sa i takon praktikave profesionale, UET ka akomoduar një numër kërkesash të studentëve për të zhvilluar praktikën në njësi të ndryshme administrative si: Bibliotekë, Librari, Zyrën e Kujdesit ndaj Studentëve, Zyrën e Karrierës dhe Praktikave, Zyrën e Aktiviteteve, Zyrën e IT-së, pranë koordinatoreve të Departamenteve.</p> <p>Megjithatë pjesa më e madhe e kërkesave janë akomoduar në institucionet dhe kompanitë me të cilat UET ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi (më poshtë jepen të dhëna të detajuara).</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit mësimor plotëson standardet dhe kriteret e cilësisë. Godinat janë rikonstruktuar dhe mobiluar së fundmi, me sistem kondicionimi dhe sistem ëireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projector. Laboratorët e informatikës janë të pajisura me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Gjithashtu edhe biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore.</p>		

Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyra dyshe. Përgjigjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë janë akomoduar në zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve janë e sallat e mbledhjeve.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, shpenzimet, kostoja për student, kontrolli financiar, kapacitetet menaxhuese.

Tregues të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në dy vitet e fundit (plotëso tabelën 8)

Tabela 8

Të ardhurat nga:	Viti 1 (2010)	Viti 2 (2011)
Pushteti qendror		
Pushteti vendor		
Fonde jopublike:		
Grantet për kërkim dhe kontratat		
Konsulencat, shërbimet		
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	99.52 %	99.05%
Sponsorizimet		
Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)		
Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj		
Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)	0.48 %	0.95%
SHUMA	100%	100%

- Shpenzimet për studentët që ndjekin programin e studimit, kosto e studimit për student për vit akademik. Studente që ndjekin vitin 2010 janë 2.869 studente. Kosto për studentë është 129.886 lekë të reja. Studente që ndjekin vitin 2011 janë 3.156 studentë. Kosto për studentë është 161.968 lekë të reja.
- Transparenca dhe kontrolli i brendshëm financiar, Auditimi dhe rezultatet. Universiteti Europian i Tiranës kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpk përmbush kuotat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Audituesi i pavarur është Z. Kostandin Pesha, me licënsë numër 163, datë 19/07/2007, Nipt K81304008V. Rezultati: Pasqyrat financiare japin një pasqyrim të drejtë të gjendjes financiare të shoqërisë në datën e mbylljes së bilancit 2010 dhe 2011, të rezultatit financiar dhe fluksit të parasë në përputhje me Standartet Kombëtare të Raportimit Financiar dhe në pajtim me ligjin nr 9228/4 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".
- Kapacitetet menaxhuese financiare
Projekti financiar hartohet në muajin Korrik të çdo viti dhe miratohet nga Aksioneri i vetëm Z. Henri Çili. Për zbatim të këtij projekti, ngarkohet Kancelari dhe Zyra e Financës. Për çdo veprim blerje dhe shitje zyra e financës pajis me "Kërkesë për Lëvrim fondesh", e miratuar nga Kancelari. Projekt buxheti hartohet në mënyrë

të tillë që gjithmonë të ketë një rezervë të të ardhurave, duke mos përfshirë të ardhurat e vitit pasardhës, që të mbulohen shpenzimet në vazhdimësi për çdo student deri në diplomimin e tij.

Dokumentacioni përkatës

Bilancet vjetore

Raportet e auditit të pavarur.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.		
Kriteri 1	Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Uet –i kryen auditime përvitshëm nga auditor i pavarur, raportet e auditit të pavarur pasqyrojnë ndarjen e shpenzimeve sipas kategorive kryesore, paga, qera, shpenzime administrative, shpenzime për kërkim zhvillimi etj.
Kriteri 2	Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	
Kriteri 3	Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.		
Kriteri 1	Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.;	Uet-i harton pasqyrat financiare dhe bilancin vjetor të cilat depozitohen në institucionet përkatëse. Mbatja e kontabilitetit kryhet me parimin e konstatimit të detyrimit. Çdo studentë është i paisur me kontratën, kasë dhe faturë tatimore për shërbimin e kryer. Ndarja e të ardhurave është me kategori sipas burimeve financiare. Shpenzimet kategorizohen sipas llogarive përkatëse. Raportet financiare mbahen në zyrën e financës. Bilancet vjetore pasqyrojnë një qëndrueshmëri financiare, kapacitete të mjaftueshëm për situatën financiare, si dhe rritja e numrit të studentëve vit pas viti një gjenerim të të ardhurave për vitet në vazhdim.
Kriteri 2	Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.	
<u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Grupi ka konstatuar organizim dhe mbajtje të rregullt të të dhënave financiare të institucionit. Dokumentacioni i lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet është i rregullt dhe dëshkohet edhe nga rezultatet e kontrolleve periodike të cilave u është nënshtruar institucioni.		

Pjesa përshkrimore

Terma reference: ngritja dhe institucionalizimi i Njësisë së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë (NjBSC), funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Cilësisë së proceseve akademike në Universitetin Europian të Tiranës (UET) i kushtohet kujdes i vecantë; sigurimi i saj ka karakter gjithëpërfshirës, shoqërohet me kërkesa gjithnjë në rritje për realizimin e të cilave nga secili punonjës kërkohet maksimumi i performancës dhe kualifikimi i vazhdueshëm.

Për sigurimin e brendshëm të cilësisë në mënyrë më specifike kujdesen strukturat organizative drejtuese të UET-it, të cilat janë ngritur e veprojnë konform kërkesave të Ligjit Nr. 9741, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë", të datës 21.05.2007, i ndryshuar si dhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) e cila në UET njihet edhe si Komisioni i Sigurisë së Brendshme të Cilësisë (KSBC). Kjo njësi e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve të ngritura ad hoc dhe që nga Janari i vitit 2011 e në vazhdim në formën e një ekipi të përbërë nga pedagogë që përfaqësojnë të tre fakultetet e UET, nga një përfaqësues nga sektorët ndihmës dhe studentët.

Aktivitetin e saj NJSBC e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendar të përvitshëm, në të cilin programohen kontrollet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen kontrollit, e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike NJSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET, rreth rezultateve të kontroleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe anëtarëve të personelit.

Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësidhënies, si dhe njohjen e rregulloreve të brendshme të UET. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit e pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin jo vetëm në njohjen e specifikave të rregulloreve të UET, por edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimin.

Kërkesat në rritje për një cilësi sa më të lartë dhe përvoja e fituar në vite kanë shtruar nevojën për një transparencë në tërë proceset akademike që realizohet përmes paraqitjes në intranet (Dokumenta UET) të programeve të lëndëve dhe dokumentacionit që lidhet ngushtësisht me procesin akademik në UET, etj, legjislacionin përkatës, urdhërat e rektoratit të UET, etj. Në këtë kuadër, për secilin program lënde që është pjesë e programeve të studimit është konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese, literaturë e cila përzgjidhet me kujdes pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit sipas grup-lëndëve dhe në departament.

Impakt të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë japin edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga "fokus grupet" si edhe pyetësorët me frekuencë semestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjerësisht në mbështetje të procesit të "follow up", gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të viti akademik.

Si rezultat i një veprimtarie intensive për sigurimin e brendshëm të cilësisë është fituar një përvojë e gjerë, e cila ka diktuar marrjen e një sërë masash me karakter organizativ dhe metodik. Kështu, theksi është vënë në forcimin e rolit dhe përgjegjësisë së departamentit në proceset akademike, janë gjetur forma të reja për kontrollin e dijeve të fituara nga studentët duke i dhënë përparësi punës individuale të studentëve, kontrollin e njohurive të fituara nga studentët përmes zhvillimit të detyrave në auditor, marrjen e masave për të mënjeluar plagjarizmin në diploma, ese, provime, etj.

Hap i rëndësishëm në drejtim të rritjes së cilësisë përbën ngritja dhe funksionimi i grup-lëndëve brenda çdo departamenti, me synim forcimin më tej të cilësisë së programeve të lëndëve që zhvillohen brenda një programi studimi dhe garantimin e një harmonizimi më të mirë të njohurive brenda të njëjtit grup-lëndësh, duke u shtrirë si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht.

Vlen të theksojmë se një sërë masash janë përfutur përmes pyetësorëve me studentët, ndër të cilët përmendim atë që lidhet me fokus grupet. Gjatë periudhës 2010–2012 janë zhvilluar takime me 9 fokus grupe me një total prej 61 studentësh të ndarë sipas Fakulteteve në UET. Ndër çështjet themelore që u ngritën nga ata adresonin

probleme mbi mësimdhënien në universitet si mangësitë e vrojtura në shkrimin akademik dhe metodat e kërkimit; vështirësitë në punimin e eseve dhe të temave të diplomës, nevoja e organizimit të më shumë konferencave, gjallërimi i jetës studentore dhe përfshirja e studentëve në projekte e kërkimin shkencor, etj.

Si rrjedhojë, nga UET janë programuar masa si ri-konceptualizimi i mënyrës së zhvillimit të eseve/detyrave të klasës/frasteve studimore; riorganizimi i këshillimit akademik përmes Shërbimeve Studentore dhe Zyrës së Dekanit të Studentëve dhe ritheksimi i orëve të tutoriatit, krijimi i adresave zyrtare të email-it (të UET-it) për çdo student; përforsimi i përdorimit në funksion të komunikimit i rrjeteve sociale si psh faqja zyrtare e UET-it në Facebook; ristrukturimi i faqes zyrtare www.uet.edu.al; angazhimi më i madh i studentëve në projekte kërkimore, në Zyrën e Projekteve dhe qendrën shkencore të UET-it, ndihma dhe asistencë për aplikime dhe shkolla verore; riaktivizimi dhe funksionimi i mirëfilltë i Bordeve të Punës për çdo department; marrëveshje bashkëpunimi me GOs dhe NGOs për Panairin e Punës; pasurimi me infrastrukturë dhe burime njerëzore i Zyrës së Karrierës dhe Praktikave; më shumë burime në Bibliotekë; abonim në revista shkencore përmes aksesit online në disa prej burimeve akademike më të mirënjohura si: Cambridge Journals Online; EBSCO Academic; etj.

Lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë vlen të theksojmë se NJSBC ka luajtur një rol të dorës së parë në akreditimet e programeve akademike që zhvillohen në UET, ku vlen të përmendet procesi i akreditimit si institucion dhe i programeve të para të studimit në Korrik 2009 (Urdhëri i Ministrit të Arsimit nr. 246, datë 24.07.2009), si edhe akreditimi i programeve të ciklit të dytë dhe programeve Master i Nivelit të Dytë (Urdhëri Nr. 68, datë 14.02.2011).

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për anëtarët e NJSBC (plotëso tabelën 9)

Tabela 9

	Anëtarët e NJSBC	Detyra që kanë në NJSBC	Sa kohë kanë në këtë detyrë
1	Përparim Fuga	Kryetar	Janar 2011
2	Elda Papa	Antar	Dhjetor 2008
3	Evis Gjebrea	Antar	Mars 2010
4	Gilman Bakalli	Antar	Mars 2010
5	Merita Kotorri	Antar	Janar 2011
6	Kleopatra Maliqi	Antar	Janar 2011
7	Enea Zafiri	Antar	Mars 2010
8	Marinela Seitaj	Antar	Prill 2012

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC si:
- o Sa anketime kanë bërë me studentët
 - o Sa studentë janë anketuar
 - o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - o Cilat kanë qënë hapat e mëtejshëm
 - o Etj

Një nga format më të përdorura mbi cilësinë në UET është pyetësori me studentët, i cili organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Skedat e pyetësorëve janë përpunuar tërësisht nga ana e personave përgjegjës për statistikat në UET, ndërsa rezultatet e fituara janë vënë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, si edhe në mënyrë të personalizuar për secilin pedagog. Njëherazi, ato kanë qënë një burim i rëndësishëm për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit, në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndër problemet më kryesore kanë qënë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimi, cilësinë në shpjegim dhe kontroll, etj.

- Kontrolli i brendshëm i cilësisë

- Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti
- Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre
- Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike
- Rezultatet e auditimit dhe vlerësimeve të jashtme
- Dokumentacioni përkatës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.		
Kriteri 1	Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;	Institucioni analizon mbi bazë fakulteti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve. Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe”, institucioni programon politika dhe ndërmer masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.
Kriteri 2	Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.		
Kriteri 1	Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;	UET ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional si edhe përsa i përket programeve të para të studimit me Vendim të Këshillit të Akreditimit nr.24, datë 19.07.2009, të shoqëruar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 246, datë 24.07.2009, si dhe Urdhërin Nr. 68, datë 14.02.2011 për Programet e Ciklit të Dytë dhe Master i Nivelit të Dytë). Sigurimi i cilësisë realizohet përmes përfshirjes së personelit akademik dhe atij ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga ana e strukturave drejtuese dhe NJSBC, tërheqjes së mendimit të studentëve, të antarëve të Bordeve të Tregut të Punës si edhe bashkëpunimit me APAAL-in dhe struktura të tjera shtetërore. Kujdes i kushtohet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fushën e arsimit, me fokusim të veçantë në standardet e cilësisë për të gjitha nivelet. Për të siguruar cilësinë e proceseve akademike UET harton politikat përkatëse përmes shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Senatën Akademik, këshillat e fakulteteve, këshillat e departamenteve. Një rol të veçantë luajnë mekanizma si grupet e punës për probleme të veçanta, ndër të cilët përmendim atë për format e kontrollit; organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe ata që janë diplomuar në UET, etj.
Kriteri 2	Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;	
Kriteri 3	Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;	
Kriteri 4	Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;	
Kriteri 5	Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;	
Kriteri 6	Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.	

		<p>Ndërgjegjësimi i personelit synohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njohurive mbi standardet dhe kërkesat e veçanta për cilësi. Po ashtu, studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik, dhe gjatë vitit në takime të veçanta me drejtuesit e institucionit, pedagogët, etj.</p> <p>Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të NJSBC dhe reflektohet në format dhe formatet standarde të publikura në intranetin e UET.</p>
<p>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p> <p>Kriteri 4</p>	<p>Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuar me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, 	<p>UET përdor metodologji vlerësimi për tërë aktivitetet me karakter kontrolli që organizohen nga NJSBC, për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Njëherazi, rekomandon detyra, zbatimin e të cilave ndiqet nga ana e strukturave drejtuese dhe vetë NJSBC.</p> <p>Institucioni kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët. Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe gjejnë reflektimin e tyre në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p>Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënat mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në UET, kalushmëria për lëndë dhe pedagog, etj.</p>

	projektet, provimet, etj.); f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës; h. Etj.	
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.		
Kriteri 1	Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;	UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, por deri më sot nuk ka ndonjë botim të publikuar për përdorim masiv.
Kriteri 2	Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj., për vlerësimin e brendshëm.	UET organizon një pyetësor/sondazh në faqen e tij të internetit mbi cilësinë e programeve, të personelit akademik, etj dhe rezultatet përkatëse reflektohen në WEB-in e UET.
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u> Sigurimit të cilësisë në UET i tregohet kujdes i veçantë, konsiderohet prioritet për secilin punonjës, ndiqet me kujdes nga strukturat drejtuese dhe monitorohet në mënyrë permanente nga NJSBC. Eksperienca e derisotme dëshmon për nevojën e një kontrolli të tillë, për domosdoshmërinë e një njësie të posaçme monitorimi, që orienton institucionin drejt plotësimit të standardeve të cilësisë dhe shërben si forcë shtytëse për një performancë në rritje në nivel institucioni dhe për çdo individ.</p>		

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit/eve të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit ofrohet me 120 kredite me kohëzgjatje normale 2 vite akademike. Programi përbëhet nga 12 lëndë, të cilat zhvillohen gjatë 3 semestrave të parë, praktikë profesionale në semestrin e fundit, dhe punimi i diplomës që shtrihet gjatë gjithë vitit të dytë të studimeve. Shpërndarja e ngarkesës është e balancuar mes semestrave. Ai ofrohet me dy profile, Financë bankë dhe Administrim biznesi. Lëndët ndjekin një radhë që është e domosdoshme për përvetësimin e tyre. Për çdo lëndë është hartuar një silabus sipas të standardit të UET, silabuset janë të gjitha të miratuara dhe u janë shpërndarë studentëve në fillim të zhvillimit të kurseve.

Programi i studimit Master i Shkencave në Informatikë Ekonomike i jep studentit informacionin e duhur për të arritur një pozicion IT-je në biznesin e tij. Në të njëjtën kohë ai i jep mundësi specialistit të IT të kuptojë dhe të familjarizohet me lehtësi në probleme të ekonomisë edhe nëse më parë nuk ka mbaruar studimet në këtë fushë, dhe së fundi i hap horizont studentit të interesuar të vazhdojë studime të mëtejshme në nivelin e doktoraturës.

Tregues të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi
- Organizimi i çdo programi studimi (vite, semestra, javë etj.)
 - 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor

- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

- Emërtimi i Diplomës për programin e studimit, Master Shkencor në Informatikë Ekonomike
- Plani mësimor sipas modelit të tabelës 10)

Tabela 10

Msc. Informatikë ekonomike		Semestri	ECTS	Orë në javë	Orë mësimore												Orë në auditor	Punë e Pavarur	Gjithsej	Provime
					Leksione			Seminare			Projekt/Detyra/Ushtrime									
					ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur	ECTS	Në auditor	P. e Pavarur							
Emri i lëndës																				
1	Aplikimi i sistemeve të informacionit	1	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
2	Kërkime Operacionale	1	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
3	Menaxhim i Sistemeve të Informacionit	1	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
4	Algoritëm, programim i avancuar (Java I)	1	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
5	Algoritëm, programim i avancuar (Java II)	2	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
6	Projektim dhe analizë e bazave të të dhënave	2	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
7	Menaxhimi i rrjetave kompjuterike	3	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
8	Menaxhim dhe vlerësim projektesh	2	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
9	Menaxhim strategjik	3	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
10	Menaxhim operacional	3	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
11	Tregu bankar dhe institucionet e tij	2	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
12	Kontabilitet nacional	3	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
13	Ekonometri	3	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
14	Web dizajn technology	3	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
15	DBMS SQL Server	3	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
16	MATLAB	2	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
17	Honor's course	2	6	4	2.5	28	34.5	2	14	36	1.5	18	19.5	60	90	150	2			
18	Praktikë / internship	4	12	40	12	255	45							255	45	300				
19	Punimi i diplomës	3-4	36	2	36	40	860							40	860	900				
Totali			120		78	631	1319	24	168	432	18	216	234	1015	1985	3000				

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit për:

- Leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- Seminaret 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit
- Projekt/detyra/ushtrime 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- Praktikën Profesionale 255 orë në auditor dhe 45 orë punë e pavarur e studentit

- Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A-F) (plotëso Tabelën 11)

Tabela 11

Plani mësimor Msc. Informatikë Ekonomike

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS	Totali
-----	------	-----	---------------	------	--------

A - DISIPLINA TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM (BAZË) 10% / 12 ECTS/ 2 lëndë

1	I	1	Aplikimi i sistemeve të informacionit	6	12
2	I	1	Kërkime Operacionale	6	

B - DISIPLINA TE FORMIMIT KARAKTERIZUES TE PROGRAMIT 40% /48 ECTS/8 lëndë

I - TË DETYRUESHME PËR TË GJITHË / 5 lëndë

1	I	1	Menaxhim i Sistemeve të Informacionit	6	30
2	I	1	Algoritëm, programim i avancuar (Java I)	6	
3	I	2	Algoritëm, programim i avancuar (Java II)	6	
4	I	2	Projektim dhe analizë e bazave të të dhënave	6	
5	II	1	Menaxhimi i rrjetave kompjuterike	6	

II - LËNDË TË DETYRUESHME SPECIFIKE / 3 lëndë

Profili:			<i>ADMINISTRIM BIZNESI</i>		
1	I	2	Menaxhim dhe vlerësim projektsh	6	18
2	II	1	Menaxhim strategjik	6	
3	II	1	Menaxhim operacional	6	
Profili:			<i>FINANCË & BANKA</i>		
1	I	2	Tregu bankar dhe institucionet e tij	6	18
2	II	1	Kontabilitet nacional	6	
3	II	1	Ekonometri	6	

C - DISIPLINA ME ZGJEDHJE/ 12 ECTS/ 2 lëndë

1	II	1	Web dizajn technology	6	12
2	II	1	DBMS SQL Server	6	
3	I	2	MATLAB	6	

D - DISIPLINA FORMUESE TË ZGJEDHURA

4	I	2	Honor's course	6	
---	---	---	----------------	---	--

E - VEPRIMTARI FORMUESE 10% / 12 ECTS / 1 lëndë

1	II	2	Praktikë / internship	12	12
---	----	---	-----------------------	----	----

F - PUNIMI I DIPLOMËS 10-25% / 30 ECTS

1	II	1-2	Punimi i diplomës	36	36
---	----	-----	-------------------	----	----

Ndryshimet në planin mësimor, krahasuar me programet e licensuara (Tabela 12)

Tabela 12

Viti I (Viti II) (Viti III)		Kategoria
Lëndë/Module		
1	Lënda 1: DBMS SQL Server	B
	Lënda 1: U hoq nga lëndë e profilit Financë Bankë dhe kaloi në kategorinë C për të dy profilet. Si lëndë profili u vendos lënda Ekonometri.	C
2	Lënda 2: Web dizajn technology	B
	Lënda 2 u hoq nga lëndë e profilit Administrim biznesi dhe kaloi në kategorinë C, për të dy profilet e programit. Në vend të saj, lëndë profile u vendos lënda Menaxhim dhe vlerësim projektsh	C
Ndryshime në total		2

Plani mësimor i lidhur me personelin akademik përkatës (plotëso Tabelën 13)

Tabela 13

Lënda /Moduli	Pedagogu/Pedagogët përgjegjës	Titulli/grada kualifikimi	Departamenti	Ngarkesa mësimore (orë)	Statusi PAE apo PAK
1 Aplikimi i sistemeve të informacionit	Petraq Papajorgji	Prof. Dr.	IMS	60	PAE
2 Kërkime Operacionale	Vasillaq Kedhi	Prof. Dr.	IMS	60	PAK
3 Menaxhim i Sistemeve të Informacionit	Mimoza Durrësi	PhD	IMS	60	PAE
4 Algoritëm, programim i avancuar (Java I)	Tamara Luarasi	Prof. Asoc. Dr.	IMS	60	PAE
5 Algoritëm, programim i avancuar (Java II)	Tamara Luarasi	Prof. Asoc. Dr.	IMS	60	PAE
6 Projektim dhe analizë e bazave të të dhënave	Petraq Papajorgji	Prof. Dr.	IMS	60	PAE
7 Menaxhimi i rrjetave kompjuterike	Mimoza Durrësi	PhD	IMS	60	PAE
8 Menaxhim dhe vlerësim projektsh	Arben Bakllamaja	Dr.	Menaxhim & Ekonomiks	60	PAE
9 Menaxhim strategjik	Herion Ndreka	Doktorant	Menaxhim & Ekonomiks	60	PAE
10 Menaxhim operacional	Aleksandër Biberaj	Dr.	Menaxhim & Ekonomiks	60	PAK
11 Tregu bankar dhe institucionet e tij	Elvin Meka	Dr.	Financë	60	PAE
12 Kontabilitet nacional	Engjell Pere	Prof. Asoc. Dr.	Menaxhim & Ekonomiks	60	PAE
13 Ekonometri	Aranit Shkurti	Dr.	IMS	60	PAE
14 Web dizajn technology	Elma Çela	Doktorante	IMS	60	PAK
15 DBMS SQL Server	Fatjon Seraj	Doktorant	IMS	60	PAK
16 MATLAB	Elida Hoxha	Prof. Asoc. Dr.	IMS	60	PAK

Syllabus-et për çdo lëndë, ku duhet të pasqyrohen këto elementë:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Dokumentacioni përkatës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret/ standartet
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.		
Kriteri 1	Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	UET si institucion dhe programet e studimit për të cilat ka lëshuar diplomë janë të akredituara, sipas legjislacionit në fuqi. Programet janë të organizuara në përputhje me udhëzimet e MASH dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Ngarkesa vjetore është 60 kredite, e ndarë në mënyrë të balancuar mes dy semestrave. Programet ofrohen me kohë të plotë.
Kriteri 2	Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.		

Kriteri 2	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;	Ky program studimi i përmbush më së miri kriteret e vendosura, pasi ofron njohuri të thelluara teorikee praktike, aftësi për punë kërkimore, duke krijuar bazat për vazhdimin e studimeve të doktoratës, për ata që synojnë një karrierë akademike.
Kriteri 3	Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	
Kriteri 4	Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;	
Kriteri 5	Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;	
Kriteri 6	Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;	
Kriteri 7	Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.		
Kriteri 1	Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;	Programi është në përputhje me këto kriteret.
Kriteri 2	Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.		
Kriteri 1	Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;	Organizimi i programit të studimit, lëndët e ofruara janë në përputhje me kërkesat e një programi të ciklit të dytë të studimeve. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura. Studentët vlerësohen në mënyrë të vazhdueshme, duke u dhënë mundësi të plotësojnë njohuritë dhe të sqarojnë paqartësitë gjatë semestrit.
Kriteri 2	Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.	
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.		

Kriteri 1	Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;	Programi është hartuar duke iu referuar përvojave më të mira bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.
Kriteri 2	Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimi në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;	
Kriteri 3	Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.	
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.		
Kriteri 1	Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;	Aftësimi profesional i studentëve realizohet jo vetëm përmes praktikës profesionale, e cila kryhet gjatë semestrit të dytë të vitit të dytë, dhe zgjat gjithë semestrin, por edhe përmes lëndëve me karakter aplikativ që ofrohen në programin e studimit. Edhe aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes lëndëve të metodologjisë, seancave metodologjike për punimin e diplomës dhe konsultimin e vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës. Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET-it dhe drejtimet e miratuara për kërkimin shkencor.
Kriteri 2	Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;	
Kriteri 3	Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;	
Kriteri 4	Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	
Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.		
Kriteri 1	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 2	Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.	
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.		
Kriteri 1	Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;	Që gjatë hartimit të programit të studimit Departamenti është konsultuar me përfaqësues të rëndësishëm të tregut të punës. Rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës pasqyrohen vazhdimisht në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen. Duke qenë se edhe vetë studentët që ndjekin studimet në këtë program janë të punësuar, mendimi i tyre ka një rëndësi të madhe në këtë drejtim.
Kriteri 2	Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin: <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën		

e Shqipërisë”, i ndryshuar.		
Kriteri 1	Programet e studimeve “Master i Shkencave” realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezën që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi ofrohet me 120 kredite. Punimi i diplomës është vlerësuar me 36 kredite. Kohëzgjatja normale e programit është 2 vite akademike.
Kriteri 2	Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.	
Kriteri 3	Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruara të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).	
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.		
Kriteri 1 Kriteri 2	Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar; Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.	Dokumenti për punimin e diplomës, pjesë e Broshurës së Dokumenteve UET, përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplomë, miratimi i temës dhe pedagogut udhëheqës nga Departamenti, procesi i shkrimit të tezës, kalendari i seancave metodologjike, e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimi dhe mbrojtja.
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.		
Kriteri 1 Kriteri 2	Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët; Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Gjithashtu studentët në fillim të secilit semestër pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve, ku jepen në detaje temat e lëndës, literatura kryesore, forma e kontrollit të dijeve, literatura e rekomanduar. Një mbledhje e departamentit në muaj është e hapur për studentët, ku diskutohen aspekte të procesit mësimor ngushtësisht të lidhura me jetën studentore dhe ku studentët mund të shprehin mendimin e tyre për çështje të programit, rregullores, apo propozime për përmirësim.
Konkluzionet e vlerësimit: Konstatohet një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore nëpër semestra dhe nga njëri vit në tjetrin. Lëndët ndërtohen mbi njëra –tjetrën për të plotësuar formimin e thelluar kërkimor dhe profesional që program ofron. Grupi vlerëson se studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit dhe lëndët e modulet e tij. Çdo fillim semestri atyre u vihet në dispozicion program i lëndëve që ofrohen (silabuset). Këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatori dhe departamenti, si dhe gjenden të printuara në librarinë e universitetit. Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden edhe në faqen e internetit të universitetit www.uet.edu.al		

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësies etj.

Bazuar në rolin që çdo disiplinë mësimore ose veprimtari formuese luan në formimin e studentit, programet e studimit organizohen në 6 kategori disiplinash:

1. Kategoria A: Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë
2. Kategoria B: Disiplina të formimit karakterizues të programit
3. Kategoria C: Disiplina të ngjashme dhe/ose integruese
4. Kategoria D: Disiplina të zgjedhura
5. Kategoria E: Veprimtari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësime kompjuterike, praktika
6. Kategoria F: Përgatitja e tezës së diplomës

Si pjesë e lëndëve të kategorive C dhe D ofrohen të ashtuquajturat "*Honors course*". Këto kurse propozohen dhe drejtohen nga pedagogë me grada dhe tituj të Universitetit. Cikle të caktuara leksionesh të tyre mund të ofrohen edhe në gjuhën angleze.

Për cikle leksionesh/module brenda lëndëve të kategorive A dhe B, mund të ftohen edhe ekspertë, profesorë të shquar të fushës.

Për një vlerësim sa më realist të cilësisë së mësimdhënies i jemi referuar disa prej elementëve që i kemi konsideruar si indikatorë të saj si më poshtë:

1. Niveli i kualifikimit të pedagogëve. Pjesa kryesore e personelit akademik (rreth 75%) përbëhet nga pedagogë të brendshëm dhe 75% e tyre kanë të paktën gradën shkencore Doktor i Shkencave. Ndërkohë ka pasur një bashkëpunim të vazhdueshëm të pedagogëve në proces doktorature me profesorët e angazhuar në program. Është pozitiv fakti që edhe pedagogët pa gradë shkencore janë të angazhuar seriozisht në punën shkencore dhe kualifikimin e tyre.
2. Mendimi i studentëve. Në UET, së paku dy herë në vit tërhiqet mendimi i studentëve, dhe rezulton se studentët janë shprehur pozitivisht për programin gjatë anketimit që është zhvilluar në kuadër të procesit të vlerësimit të cilësisë së punës.
3. Mjetet didaktike. Në zhvillimin e lëndës janë përdorur gjerësisht mjete didaktike si tabela, kompjuteri, projektori, etj. Për programimin, studenti shpesh ka pasur nevojë që duke ndjekur zhvillimin e mësimit të punojë dhe vetë në kompjuter. Një mundësi e tillë i është krijuar pasi pedagogu ka demonstruar në kompjuter dhe studenti po ashtu ka mundur që të ndjekë shpjegimin e pedagogut nga projektori. Një gjë e tillë është bërë e mundur duke e zhvilluar mësimin në sallën e kompjuterëve, çka e ka bërë atë shumë tërheqës për studentin dhe që të kuptohet më mirë nga ai.
4. Literatura në dispozicion. Literatura në dispozicion të studentëve ka qenë e bollshme, shpesh e sugjeruar në formë librash dhe referencash, kryesisht nga Interneti. Por këto referenca janë shoqëruar gjithmonë me leksione të shkruara. Eksperienca tregon se pavarësisht librave që referohen, materialet e shkruara preferohen shumë nga studentët. Kryesisht literatura është zgjedhur e viteve të fundit, duke parë dhe vlerësime të saj nga interneti.
5. Vlerësimi i studentëve. Një rëndësi e veçantë i është kushtuar vlerësimit të studentit që është bërë në përputhje me rregulloren. Janë zhvilluar teste të shkurtra përveç provimit të ndërmjetëm dhe atij përfundimtar, të cilat kanë përcaktuar edhe vlerësimin për angazhimin e studentit në seminare. Një praktikë e tillë e ka mbajtur më të angazhuar studentin gjatë gjithë kohës. Detyrat (10%-she), dy të tilla që plotësojnë një vlerësim prej 20%, janë dhënë paraprakisht, por me qëllim që me to një pjesë e punës të realizohet në klasë. Studentit i është lejuar të ketë të gjithë materialin e marrë në mësim në dispozicion, ndërsa i është kërkuar që programin ta përfundojë dhe ta ekzekutojë atë në praninë e pedagogut.
6. Vlen të përmendet këtu se cilësia e mësimit është lidhur dhe me punën shkencore të vazhdueshme që pedagogët kanë realizuar, të pasqyruar në artikuj, pjesëmarrjen në konferenca si dhe materiale të shkruara për UET. Në

materialet që studentëve u sugjerohen janë përfshirë edhe vetë punimet e pedagogëve në fushat përkatëse. Kjo gjë përbën një detyrim profesional e moral për pedagogët, që në një lëndë që zhvillojnë të kenë dhe kontributin e tyre shkencor. Kjo ka rritur cilësinë e mësimdhënies dhe besueshmërinë e studentëve tek personelin akademik.

7. Një obligim i pedagogëve ka qenë dhe mbetet pjesëmarrja e tyre në Ciklin e Tretë të studimeve përmes udhëheqjeve të doktoraturave, e cila do të inkurajojë studentët aktualë në vazhdimin e mëtejshëm të studimeve, por dhe do t'i bëjë ata të mendojnë në mënyrë më racionale për përmbajtjet e lëndëve në nivelin Master i Shkencave.

Tregues të matshëm:

- Ngarkesa totale në auditor për Format e mësimdhënies, (plotëso Tabelën 14)

Tabela 14

Programi i Studimit Msc. Informatikë Ekonomike		
Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	376
b.	Seminare	168
c.	Ushtrime/detyra	216
d.	Laboratore	
e.	Praktikë lëndore	
f.	Praktikë profesionale	255
g.	Etj	
Në total		1015

- Format e kontrollit të njohurive (plotëso Tabelën 15)

Tabela 15

Format e kontrollit të njohurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	20%
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	40%
Etj	
Në total	100%

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.(Plotëso Tabelën 16)

Tabela 16

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	6
Për projekte shkencore në rang Departamenti	3
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Në programet e studimit, të ofruara në UET, pranohen për t'u regjistruar shtetasit shqiptarë ose të huaj që plotësojnë këto kushte:

- Vërtetojnë me dokument zyrtar zotërimin e dëftesës së pjekurisë ose të diplomës përkatëse të shoqëruar me certifikatën e notave që bën të mundur regjistrimin në programin e studimit, sipas legjislacionit në fuqi dhe sipas rregullores së programit të studimit përkatës;
- Dorëzojnë dokumentet e nevojshme për lidhjen e kontratës me UET-in;
- Plotësojnë të gjitha kriteret e pranimit të përcaktuara nga organet drejtuese të UET-it;
- Shtetasit shqiptarë që kanë përfunduar shkollën e mesme jashtë vendit, duhet të ndjekin procedurën e njohjes së diplomës në MASH, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Kryejnë pagimin e tarifës së caktuar vjetore dhe/ose të plotë sipas kushteve dhe përcaktimeve të kontratës përkatëse mes UET-it dhe Studentit;

Pranimi i studentëve i nënshtrohet një procedure përzgjedhëse, nën drejtimin e organit përgjegjës për organizimin dhe administrimin e programit të studimit, duke u bazuar në formularin e aplikimit dhe në dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti. Përzgjedhja e kandidatëve për studentë për programet e ciklit të parë bëhet nga një komision përkatës i caktuar nga Këshilli i Fakultetit. Për të shqyrtuar dhe miratuar akordimin e bursave të pjesshme dhe të plota të studimit, ngrihet Komisioni i Akrodimit të Bursave. UET ofron lloje të ndryshme bursash, si bursa sociale për shtetas në nevojë, bursa të pjesshme për maturanët që kanë përfunduar shkollën e mesme me mesatare mbi 9.2 dhe 9.5, burse ekselence për studentët me rezultate të larta gjatë studimeve në UET, burse lidshipi dhe bursa VIP për persona të njohur për arritje në fushën e artit, sportit, etj.

Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të çdo fakulteti të UET-it për një mësim normal dhe brenda standardeve të kërkuara nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në përputhje me Ligjin nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me aktet nënligjore përkatëse, me Rregulloren dhe me Statutin e UET-it. Kur Presidenti e sheh të arsyeshme ngarkon Rektoratit të organizojë zhvillimin e një testi përzgjedhës. Në këtë rast pranohen ata kandidatë që kalojnë testin e zhvilluar.

Shpërndarja e studentëve sipas profileve tregohet në Tabelën më poshtë. Vihet re se numri i studentëve që e kanë zgjedhur këtë program studimi ka mbetur thuajse në të njëjtin nivel, me një alternim të lehtë të profilin të preferuar.

Pjesa më e madhe e studentëve të regjistruar kanë përfunduar studimet e Cklit të Parë në Universitetin Politeknik të Tiranës, ndaj zgjedhja e njërit prej profileve nuk duket se ndikohet nga profili i studimeve që kanë ndjekur në Ciklin e Parë.


	2010-2011	2011-2012
Administrim Biznesi	7	5
Financë-Bankë	5	9

Studentët që ndjekin programin Master i Shkencave janë specialistë nga biznese të ndryshme; ata kanë shprehur interes të madh për atë çka kanë bërë dhe mendimi i tyre ka qenë mjaft pozitiv dhe optimist për t'i aplikuar njohuritë e marra në aktivitetet e tyre.

Në Tabelat dhe grafiket më poshtë paraqiten të dhënat statistikore mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe rezultatet e studentëve për Programin Master i Shkencave:

Studentët në hyrje



NOTAT	NR. STUDENTEVE
<=4	0
<=5	1
<=6	1
<=7	6
<=8	3
<=9	1
<=10	0



Rezultatet e vitit 2010–2011

LENDA	KODET	NOTA MEZATARE	KALUESHMËRIA
Menaxhim i Sistemeve të Informacionit	CIS430	8.6	100%
Aplikimi i sistemeve të informacionit	CIS422	6.8	100%
Algoritmikë, Programim i avancuar (Java I)	CIS510	8.2	100%
Algoritmikë, Programim i avancuar (Java II)	CIS534	8.9	100%
Kërkime operacionale	MATH500	6.1	72%
Menaxhimi i Rrjetave Kompjuterike	CIS490	8.9	100%
Projektim dhe analizë e bazave të dhënave	CIS518	8.8	100%
Menaxhimi operacional	BUS430	7.6	85%
Tregu bankar dhe institucionet e tij	ECON485	5.5	80%

Një paraqitje grafike e rezultateve të Programit Master i Shkencave do të ishte si më poshtë.



Rezultatet në të dy programet Master Profesional dhe Master i Shkencave të vitit të parë janë mjaft pozitive dhe konfirmojnë edhe interesin e studentëve për këtë program; por njëkohësisht këto rezultate dëshmojnë edhe për angazhimin e pedagogëve për ta bërë atë sa më të asimilueshëm nga studentët. Faktor përcaktues ka qenë edhe fakti që mësimet janë bërë jo vetëm teorikisht, por edhe të konkretizuar në kompjuter, në kushte laboratorike bashkëkohore që kanë ndihmuar për zhvillimin cilësor të lëndës.

Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve
- Kushte specifike të pranimit të studentëve
- Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve (plotëso Tabelën 17)

Tabela 17

Programi i studimit Msc në IE	Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë)	Nota Mesatare	Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse)	Nota Mesatare
2010	12	6.9	N/A	N/A
2011	14	6.9	N/A	N/A
Në total	26			

- Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend
- Të dhëna për punësimin e studentëve (plotëso tabelën 18)

Tabela 18

Periudha e të dhënave (psh. 2008-2010)			
Programi i studimit	Numri total të diplomuarve	Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)	Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)
MSc në IE	N/A	N/A	N/A

Programi është i ri dhe nuk ka të dhëna të tilla.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.		
Kriteri 1	Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare	<p>Në program janë regjistruar studentë të cilët zotërojnë diplomë bachelor me 180 kredite, ose diplomë të sistemit të vjetër 4 vjecare.</p> <p>Studentët e regjistruar plotësojnë kriteret e përcaktuara nga UET.</p> <p>Në përfundim të programit të studimit, studentët duhet të mbrojnë gjuhën angleze, sipas udhëzimeve në fuqi, në mënyrë që të pajisen me diplomë.</p> <p>Politikat e pranimit të studentëve kanë ardhur duke u konsoliduar. Megjithatë, vlen të theksojmë se në UET përpara fillimit të vitit akademik organizohen takime pune për të vlerësuar çfarë ka nevojë të përmirësohet për vitin në vijim dhe ndryshimet e nevojshme në dokumentacionin rregullues.</p>
Kriteri 2	“Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	
Kriteri 3	Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	
Kriteri 4	Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	
Kriteri 5	Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit Europian të Gjuhëve;	
	Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.	
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.		
Kriteri 1	Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	<p>Gjatë javëve të regjistrimit, UET vë në dispozicion të studentëve të interesuar për të vazhduar studimet e master grupe pedagogësh, sipas fakulteteve, të cilët japin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen e tyre, rregulloren e universitetit, mundësitë e punësimit,</p>
Kriteri 2	Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;	
Kriteri 3		

	Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	mundësitë e transferimit të studimeve në UET, ose nga UET në institucione të tjera brenda ose jashtë vendit. Gjithashtu Zyra e Karrierës dhe Praktikave mbështet studentët gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve duke ofruar konsulencë për aplikime dhe shpërndarë informacion për mundësitë e punësimit, apo mundësitë për vazhdimin e specializimeve e doktoratës brenda ose jashtë vendit.
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.		
Kriteri 1	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	Në UET është ngritur Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikave, e cila është përgjegjëse për përpunimin e statistikave në nivel institucioni, duke u koordinuar me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës. Universiteti mban rekorde të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar, si edhe studentët e diplomuar për program studimi. Programi i studimit që po vlerësohet pritet të diplomojë së shpejti studentët e parë, ndaj për të këto të dhëna nuk janë ende të disponueshme.
Kriteri 2	Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo	
Kriteri 3	mospërfundimin me sukses të vitit akademik; Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.		
Kriteri 1	Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;	Zyra e Karrierës dhe Praktikave mban kontakte me studentët e diplomuar duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UET ose institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Që nga viti 2009 kur u diplomuan studentët e parë, në UET është ngritur edhe shoqata Alumni, me përfaqësuesit e së cilës zhvillohen takime të vazhdueshme për të vjelur mendime në lidhje me përmirësimet e mundshme që do të duhet të bëhen në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'iu përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve bashkëkohore në Europë e më gjerë.
Kriteri 2	Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.	
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.		

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p> <p>Kriteri 3</p>	<p>Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen që në momentin e regjistrimit dhe në vijimësi. Informacioni ndodhet në faqen e internetit të universitetit, u dërgohet elektronikisht përmes adresave elektronike, si edhe shpallen në tabelat e njoftimeve.</p> <p>Pas secilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, për të sqaruar cdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve.</p>
<p>Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.</p>		
<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Zyra e Kujdesit ndaj Studentit ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore. Ky shërbim nuk zëvendëson këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe Praktikave është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <p>Grupi vlerëson se shërbimi i kujdesit ndaj studentit shtrihet nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij. Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes tutoriatit dhe këshillimit akademik, studenti në UET mund t'i drejtohet edhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyrës së Karrierës dhe Praktikave, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë UET-it. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazhdimisht focus grupe për të marrë informacion në lidhje me aspektet që kanë nevojë të përmirësohen, por edhe nevojave dhe ndihmës ndaj studentëve që kanë mbetur prapa me studime, duke u ofruar mbështetjen e nevojshme, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të UET, për të kapërcyer vështirësitë që mund të jenë bërë pengesë për mbarëvajtjen e studimeve.</p>		

POLITIKA E KËRKIMIT SHKENCOR.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e

organizuar nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien, vlerësime zyrtare të aktivitetit kërkimor individual ose për njësinë.

Duke filluar nga viti akademik 2010-2011, UET ka një pozicion të ri dedikuar posaçërisht Kërkimit Shkencor, që është posti i Zv/Rektore për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë. Posti synon koordinimin e gjithë hallkave të kërkimit shkencor që nga fakultetet/departamentit, Shkolla Doktorale dhe pasurimi i përhershëm i bibliotekës, si dhe ruajtja e standardeve të botimit në revistat shkencore të UET-it.

Kërkimi shkencor në UET zë një vend qendror dhe është baza e mësimdhënies e personelit akademik. Kërkimi shkencor bazohet në tre shtylla: Shkollën Doktorale, Revistat shkencore, si dhe Biblioteka dhe njësia e lëndëve metodologjike në UET, nga niveli Bachelor deri në atë Doktorat. Aktorët të cilët përfshihen në të tre këto shtylla janë së pari departamentet, por dhe Institutet dhe Qendrat Kërkimore—si Instituti për Studime dhe Politika Sociale, Instituti për Studime të Ballkanit dhe Instituti i Historisë Bashkëkohore.

Posti i Zv/Rektore për Kërkim Shkencor dhe Metodologji bashkëpunon ngushtë me Qendrën UET për Projekte dhe Kërkim Shkencor, me synim koordinimin e burimeve njerëzore për projekte të ndryshme kërkimore.

Shkolla Doktorale dhe Kërkimi Shkencor: Shkolla doktorale ka një rëndësi kyçe, sepse nxjerr hulumtuesit e parë dhe punonjësit e parë shkencorë të përgatitur në UET. Po ashtu, Shkolla doktorale ofron udhëheqje shkencore për kandidatet doktorale dhe strukturon punën kërkimore të stafit akademik sipas drejtimeve specifike kërkimore.

Në bashkëpunim me tre Fakultetet përbërëse, Shkolla Doktorale në UET ka strukturuar kërkimin shkencor dhe drejtimin e punës kërkimore të kandidatëve doktoralë sipas Drejtimeve Kërkimore për secilin program studimi. Drejtimet Kërkimore të Shkollës Doktorale drejtohen pedagogje dhe studiues me gradën më të lartë dhe numrin më të madh të botimeve në fushën përkatëse dhe përbëhet si nga studentë doktoralë, ashtu dhe nga një 3 deri në 5 udhëheqës doktoralë. Konferencat doktorale janë strukturuar sipas Drejtimeve Doktorale. Organizimi sipas Drejtimeve Kërkimore synon të arrijë të paktën tre objektiva: Së pari, të prodhojë ekspertizë të nivelit ndërkombëtar në një fushë të caktuar dhe të kthejë UET-in në një burim të vazhdueshëm dijeje dhe konsulence si për komunitetin akademik, ashtu dhe për aktorë të tretë. Së dyti, rritja profesionale e stafit akademik dhe kërkimor të UET-it brenda ekspertizave dhe fushave të tyre të interesit shkencor. Së fundi, krijimi i një komuniteti—ose disa komuniteteve—kërkimore të cilët ndërveprojnë vazhdimisht me njëri tjetrin në funksion të gjetjeve dhe analizave sa më të arrira dhe bindëse.

Revistat Shkencore: Në UET botohen katër revista shkencore: revista *Polis* e Shkencave sociale, revista *Jus & Justicia* e Fakultetit Juridik dhe revista *Economicus* e Fakultetit Juridik, si edhe *Sociological Analysis* e cila botohet në gjuhën angleze. Po ashtu, Departamenti i Edukimit është në proces të licensimit të revistës *Educatio*, e cila do të ketë bord ndërkombëtar dhe do të botohet në anglisht. Për momentin, po punojmë drejt lancimit të një reviste elektronike në anglisht që do të jetë *open-access*, ku studiuesit tanë apo të universiteteve të tjera të botojnë online.

Artikujt për botim në revistat shkencore të UET-it, i nënshtrohen procesit të '*blind review*' ose recensimit anonim; kjo do të thotë, që çdo artikull i ardhur në redaksi i shpërndahet nga redaksia një specialisti më afër fushës së botimit. Çdo numër i revistave shkencore paraprihet nga një 'Thirrje për Kontribute' të redaksisë. Revistat *Jus & Justicia*, *Polis* and *Economicus* botohen dy herë në vit.

Departamentet: Çdo departament dhe Fakultet i dorëzon në fillim të vitit akademik Zv/Rektore për Kërkim Shkencor dhe Metodologji kalendarin e aktiviteteve shkencore (konferenca/workshop-e, kolokiume shkencore etj). Po ashtu, mbledhja e fundit e muajit (mbledhja javore) në çdo departament ka për tematikë kërkimin shkencor brenda departamentit, zhvillime të reja në fushën e botimeve, promovimin dhe pjesëmarrjen e stafit në konferenca.

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor (plotëso Tabelën 19)

Tabela 19

Aktivitete të planifikuara individuale dhe në rang programi studimi, në vitet e fundit	
1.	Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL
	Rreth 77 Botime shkencore në revista dhe monografi si autor i parë, si dhe 37 pjesëmarrje me kumtesa në konferenca shkencore të stafit akademik të Fakultetit Juridik.

		<p>Rreth 245 Botime shkencore si monografi, ose libra me autorë të pare dhe artikuj shkencorë të Fakultetit Ekonomik dhe IT, plus rreth 265 kumtesa të stafit në konferenca dhe aktivitete shkencore.</p> <p>Rreth 74 botime shkencore (artikuj dhe libra, monografi ose autorë të parë të stafit efektiv të Shkencave Sociale dhe Edukimit, si dhe rreth 68 kumtime në konferenca brenda dhe jashtë vendit, vetem ne dy vitet e fundit akademike (2010-2011/ 2011-2012).</p> <p>Të dhënat e plota për kërkimin shkencor të stafit efektiv mund të vihen në dispozicion, nëse është e nevojshme.</p>
2.	Numri i projekteve kërkimore të fituara	3 (RRPP+B.C+COST)
3.	Numri i projekteve të zbatuara	8
4.	Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, për programin e studimit	21
5.	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL	-
6.	Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor	Tempus/Jean Monnet
7.	Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor	5
8.	Numri i Çmimeve Kombëtare	Çmimi Kult 2011 për studiuesin Ferit Duka.

Dokumentacioni Përkatës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret		Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.		
Kriteri 1	Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disipinën përkatëse;	Studime të personelit akademik botohen rregullisht në revistat akademike për çdo fakultet në UET: Polis, Economicus, Jus & Justicia, Sociological Analysis, Educatium.
Kriteri 2	Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.	<p>Në kuadër të projektit Jean Monnet Chair, stafi kyç i angazhuar në projekt, por edhe anëtarë të tjerë të stafit akademik, kontribuojnë me artikujt mbi integrimin European të publikuara në web-site e dedikuar JM por edhe në Revistat shkencore Economicus dhe Polis. Për më tepër, kurrikulat mësimore që prekin integrimin European por edhe fushat ndërdisiplinare, janë strukturuar me qëllim përmirësimin e infrastrukturës mësimore mbi integrimin European.</p> <p>Në kuadër të projektit Tempus për të Drejtat e Njeriut në arsimin e lartë, personeli akademik i përfshirë studion përmbajtjen dhe mënyrat e mësimdhënies së kurrikulave për të Drejtat e Njeriut në arsimin e lartë dhe zhvillon kërkim për rikonceptualizimin e kurrikulave me në qendër të Drejtat e Njeriut, mënyra alternative të mësimdhënies dhe metodologjinë. Këto punime botohen tek faqja zyrtare e projektit si dhe revistat akademike të universitetit dhe partnerëve.</p> <p>Personeli akademik jep kontribut në zhvillimin e kërkimit shkencor: integrimi european nën lupën akademike; metodologjia për të drejtat e njeriut në arsimin e lartë.</p>

		Pjesëmarrja në konferenca shkencore brenda dhe jashtë universitetit. Studimet botohen në revistat shkencore të universitetit në formën e policy-paper me rekomandimi me politikëbërjen dhe qeverisjen.
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.		
Kriteri 1	Personeli akademik që angazhohet në	Më shumë se gjysma e lëndëve të programit Master Profesional në Qeverisje e Korporatave është zhvilluar në gjuhën angleze. Pedagogët që kanë zhvilluar mësimin janë ose të huaj, ose shqiptarë të shkolluar në institucione që përdorin anglishten si gjuhë zyrtare.
Kriteri 2	mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj; Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.	Lënda 'Shoqëria dhe Politika në SHBA', lëndë në nivel Masteri për studentët e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në anglisht. Pedagog: Fatos Tarifa, PhD në Sociologji nga University of South Carolina, në Chappel Hill, USA.
Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.		
Kriteri 1	Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;	- Universiteti organizon në mënyrë periodike Staff Development Day – Ditën e Zhvillimit të Stafit, me synimin trajnimin e stafit në fusha të lidhura me mësimdhënien, kërkimin, projektet, metodologjinë dhe TIK.
Kriteri 2	Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.	- Anëtarë të stafit akademik të UET marrin pjesë në Programin Europian për Shkencë dhe Teknologji COST. - Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit është e angazhuar për të përfshirë stafin akademik në projekte kërkimore të lancuara nën programin FP7, në Konsortiume me partnerë ndërkombëtarë. - Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET përgatit dhe shpërndan tek personeli akademik informacion në lidhje me mundësi aplikimi për programe kërkimore, trajnime dhe kualifikime si dhe ofron konsulencë për zhvillimin e aplikimeve. - Anëtarë të stafit akademik marrin pjesë në trajnimet për metodologjinë në kërkimin shkencor në shkencat sociale në kuadër të Programit të Promovimit të Kërkimit Rajonal – RRPP.
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.		
Kriteri 1	Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	-Secili Fakultet ka ne dispozicion Axhenden Kerkimore te Secilit Pedagog ne harkun e 5 viteve, si dhe nje baze te plote te dhenash te punes kerkimore, botimeve dhe pjesemarrjeve me kumtese ne konferenca brenda dhe jashte vendit te stafit ne fund te cdo viti akademik.
Kriteri 2	Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	- Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET disponon një bazë të dhënash (Excel spreadsheet) me detaje të projekteve kërkimore, zhvillimi, ndërtim-kapacitetesh etj.në të cilat ka marrë pjesë ose është aktualisht i përfshirë personeli akademik, si dhe me detaje të projekteve në aplikim/të ardhshme. Baza e të dhënave përmban: detaje për projektin; për donatorin; për partnerët; për personelin akademik të përfshirë; etj.
Kriteri 3	Institucioni disponon një	

	bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Grupi konstaton se janë hedhur hapa të rëndësishëm përpara në drejtim të organizimit dhe bashkërendimit të punës kërkimore shkencore të personelit akademik, në rang departamenti e më gjerë. Infrastruktura në dispozicion të angazhimit të pedagogëve në veprimtari kërkimore shkencore është përmirësuar. Çdo departament planifikon çdo fillim viti veprimtaritë shkencore që do të organizojë, i vetëm ose në bashkëpunim me departamente të tjera, ose universitete partnere. Revistat shkencore të çdo Fakulteti ofrojnë një hapësirë të mirë për publikimin e rezultateve të punës kërkimore të personelit akademik, sigurisht duke respektuar kriteret e vendosura nga bordi editorial. Zyra e Projekteve shërben si katalizator për të indentifikuar projekte dhe koordinuar përfshirjen e pedagogëve në projekte që përputhen me interesat dhe ekspertizën e tyre shkencore. Megjithatë, vihet re se niveli i interesit të pedagogëve për t'u aktivizuar në projekte kërkimore-shkencore nuk është në shkallën e duhur, ndaj është menduar që kontrata e re e punës do të parashikojë detyrimin e pedagogëve për të bashkëpunuar me Zyrën e Projekteve, në projekte që përputhen me kualifikimin e tyre.</p>		

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Marrëdhëniet e partneriteteve në UET kanë përbërë një ndër drejtimet e veprimtarisë së tij akademiko-shkencore. Ato kanë qënë konceptuar përgjithësisht si marrëdhënie me jashtë, duke u kufizuar kryesisht në krijimin e lidhjeve permanente institucionale e juridike midis UET dhe universiteteve apo institucioneve akademike e shkencore të huaja.

Bashkëpunimi me jashtë i UET-it, i konceptuar dhe i realizuar si i tillë, ka synuar zgjerimin dhe institucionalizimin e lidhjeve nëpërmjet nënshkrimit të marrëveshjeve, protokolleve, memorandumeve të mirëkuptimit etj. si bazë e qëndrueshme juridike për zhvillimin normal të bashkëpunimit midis institucioneve universitare. Ky është konsideruar si element favorizues për përmbushjen e një prej komponenteve të rëndësishëm të veprimtarisë së UET-it, për shkëmbimet e stafeve dhe të studentëve, në kuadër të angazhimeve të Kartës së Bolonjës.

Në këtë kuadër, gjatë viteve të fundit janë realizuar marrëveshje bilaterale bashkëpunimi me një numër relativisht të madh universitetesh apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë. Në keto akte janë parashikuar shkëmbime pedagogesh nga stafi akademik, shkëmbime studentësh, pjesëmarrje në programe, projekte dhe veprimtari të tjera të përbashkëta akademike e shkencore organizim doktoraturash të përbashkëta, etj.

Ndërkohë, janë realizuar shkëmbime pedagogësh, vizita studentësh, konsultime për lëndë dhe botime të ndryshme, konferenca të përbashkëta shkencore, etj.

UET-i është pjesëmarrës dhe anëtar i disa institucioneve apo organizatave ndërkombëtare joqeveritare të fushës akademiko-shkencore, numri i të cilave synohet të shtohet në të ardhmen.

Ai ka qënë organizator ose bashkëorganizator i një vargu veprimtarish të rëndësishme shkencore ndërkombëtare në Shqipëri apo në vende të tjera.

Ka pasur pjesëmarrje të gjerë të pedagogëve të UET-it në konferenca shkencore ndërkombëtare jashtë shtetit si në Itali, Francë, Zvicër, Poloni, Mali i Zi, Britaninë e Madhe, Izrael, Vietnam, Kili, SHBA, Turqi, Kosovë, Bosnjë-Hercegovinë, etj. si dhe janë tërhequr në auditoret e UET-it, një numër relativisht i konsiderueshem pedagogësh të huaj ose shqiptarë, por

që kanë kryer studimet dhe kanë marrë grada e tituj shkencorë në universitete prestigjioze të huaja. *Ka pasur të tillë nga Franca, Anglia, Italia, SHBA, Zvicra, etj.*

Tregues të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar (plotëso Tabelën 20)

Tabela 20

Aktivite shkencore individuale dhe në rang Programi studimi në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar në vitet e fundit		
1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare	2 (Cost dhe Tempus)
2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj ose orë mësimore)	83
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL	<u>2010-2011</u> 65 studente te transferuar ne UET. <u>2011-2012</u> 118 studente te transferuar ne UET.
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	- Zv/Rektor për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë; - Zv/Rektor për Partneritetet, Kërkimin dhe Zhvillimin e Biznesit; - Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit, koordinon Rrjetin UET që përshin: Fondacioni për Liri Ekonomike Qendra Rajonale e Ekspertizës për Zhvillimin e Qëndrueshëm Instituti i Studimeve Strategjike dhe Sigurisë Instituti i Historisë Bashkëkohore Instituti i Studimeve Sociale dhe të Politikave Qendra për Studime Gjinore Qendra për Ligjin, Normat dhe Traditën - Asociimi me Think Tank Qendra UET - 4 Revista Shkencore (Economicus, Polis, Jus & Justicia, Sociological Analysis)
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	Rreth 11 pjesemarrje me kumtesa ose prezantime nga stafi i Fakultetit, Juridik, rreth 46 prezantime dhe kumtesa jashte vendit per Fakultetin Ekonomik & IT dhe rreth 10 pjesemarrje jashte vendit per Fakultetin e Shkencave dhe Edukimit.
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	- Alumni Grant Program (AGP) of the Open Society Foundations Scholarship Programs for the year 2013 – Research Project Award – ‘Measuring and Promoting Internal Party Democracy in Albania’; - Winning research project of the Global Research Competition held under the Global Research Capacity Building Programme, GLOBAL DEVELOPMENT NETWORK – ‘To what extent has the Albanian and Kosovo party system institutionalized since democratization?’ - Winning research project supported by Open

	Society Foundation for Albania – Inclusive Education; - Start up Weekend, Albania – Grandmothers' Employment (prill 2012) - <i>The innovative research project Handmade Albania: social innovation and entrepreneurship is awarded First Prize in the Albanian National Business Plan Competition - OECD Investment Compact for South East Europe, METE, AIDA, with the support of the European Union.</i>
--	--

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (Plotëso Tabelën 21)

Tabela 21

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese	Lloji i bashkëpunimit
Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile	Donatorë
12 Qarqet e Shqipërisë	Partnerë
Bashkia e Tiranës	Partnerë
Agjencia për Kërkimin, Teknologjinë dhe Inovacionin	Partnerë
Instituti i Trajnimit të Administratës Publike	Partnerë
Organizatrat Profesionale	
SOROS	Donatorë
World Bank	Donatorë
Swiss Agency for Development	Donatorë
British Council	Partnerë/Donatorë
USA Embassy	Donatorë
European Commission	Donatorë
COST	Donatorë
University of Fribourg	Donatorë
University of Mannheim	Partnerë
University of Gothenburg	Partnerë
University of Sarajevo	Partnerë
University of Zenica	Partnerë
University of Kragujevac	Partnerë
University of Novi Sad	Partnerë
University of Beograd	Partnerë
University of Donja Gorica	Partnerë
University of Montenegro	Partnerë
National University Ireland	Partnerë
University of Pristina	Partnerë
International Business School Budapest	Partnerë
Koblenz-Landau University	Partnerë
University of Potsdam	Partnerë
Munich University of Applied Sciences	Partnerë
University of Thessaly	Partnerë
University of Egingen	Partnerë
Van Hall Larenstein University of Applied Sciences	Partnerë
Scottish Agricultural College	Partnerë
Staffordshire University	Partnerë
FHS St.Gallen,	Partnerë

Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese	
Institucionet qeveritare bashkëpunuese	Lloji i bashkëpunimit
Hochschule für Angewandte Wissenschaften	
Charls University	Partnerë
University of Jyväskylä	Partnerë
University of Århus	Partnerë
University of Salento	Partnerë
University of National and World Economy	Partnerë
Foundation for European Policy Studies	Partnerë
Risk Monitor Foundation	Partnerë
University of Zagreb	Partnerë
Universiteti Cyril & Methodius	Partnerë
Mobility IT, Italy	Partnerë
Gruppo Sigla, Italy	Partnerë
Everis Spain	Partnerë
Trebag Property and Projectmanagement Ltd, Hungary	Partnerë
BSC Consultants, Greece	Partnerë
Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli	Partnerë
Center for Security Studies, Serbia	Partnerë
International Progressive Education, Kosovo	Partnerë
Association Alumni of the Center for Interdisciplinary Postgraduate Studies, Bosnie Hercegovinë	Partnerë
South East European University, Maqedoni	Partnerë
Mediterranean University Podgorica, Maqedoni	Partnerë
New Business Education Foundation, Maqedoni	Partnerë
EMBRA, Maqedoni	Partnerë
Group for Legal and Political Studies, Kosovë	Partnerë
PVPU Euro College, Maqedoni	Partnerë
Komuniteti i biznesit, tregu i punës	
Instituti i Shërbimeve të Konsulencës Manaxheriale	Partnerë
ABC	Donatorë
BRIC-AIDA	Donatorë/ Partnerë

Dokumentacioni përkatës

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi për Kriteret dhe standardet
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	

<p>Kriteri 1</p> <p>Kriteri 2</p>	<p>Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndër marrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>UET ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi, ku parashikohet edhe bashkëpunimi në funksion të kryerjes së praktikave profesionale të studentëve, me institucionet si më poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrëveshje bashkëpunimi me “SPI Albania” • Mem. bashkëpunimi UET – Arkivi i Shtetit • Mem. bashkëpunimi UET – Instituti i Medias • Mem. bashkëpunimi UET – Gjykata <p>Kushtetuese</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare <p>Mbikqyrjes Financiare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – KKRT • Mem. bashkëpunimi UET – Top Channel • Mem. bashkëpunimi UET – RTSH • Mem. bashkëpunimi UET – Instituti i Kurrikulave • Mem. bashkëpunimi UET – Qendra e Studimeve Albanologjike <p>Studimeve Albanologjike</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – MPÇSSHB • Mem. bashkëpunimi UET – Instituti i Studimeve Ndërkombëtare <p>Ndërkombëtare</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – Instituti “Agenda” • Mem. bashkëpunimi UET – Instituti i Studimeve Bashkëkohore <p>Bashkëkohore</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – Ministria e Drejtësisë <p>Drejtësisë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – “Kalo & Associates” • Mem. bashkëpunimi UET – Autoriteti i Konkurrencës <p>Konkurrencës</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – Instituti për Demokraci dhe Integrim <p>Demokraci dhe Integrim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – Qendra për Zhvillim Ekonomik & Social <p>Ekonomik & Social</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – Agjencia e Vlerësimit të Arritjeve <p>Vlerësimit të Arritjeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mem. bashkëpunimi UET – INSTAT • Mem. bashkëpunimi UET – Qendra e Studimeve Sociale <p>Studimeve Sociale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Marrëveshje bashkëpunimi me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë (SH S SH) dhe Institutit të Inxhinierisë Financiare (IFIBI) • (PARSH) Projekti për Arsimimin e të Rriturve në Shqipëri • Memorandum Bashkëpunimi me Këshillin e Qarkut Durrës • Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin Shtetëror të Tetovës, Maqedoni • Marrëveshje Bashkëpunimi me Kryqin e Kuq Shqiptar • Marrëveshje Bashkëpunimi me Dhomën e Tregtisë, Tiranë • Marrëveshje Bashkëpunimi Procredit Bank • Marrëveshje Bashkëpunimi me Vodafone Albania
<p>Konkluzionet e vlerësimit: Grupi vëren se UET ka krijuar lidhje të qëndrueshme me një mjaft institucione të administratës publike dhe të komunitetit të biznesit, dhe organizatave jofitimprurëse. Krahas këtyre marrëveshjeve të bashkëpunimit, çdo</p>		

department ka krijuar edhe Bordin e Tregut të Punës, ku janë ftuar të marrin pjesë përfaqësues të shquar për arritje në fushën e programeve të studimit që administrohen nga departamenti. Këto Borge ofrojnë konsulencë për të rritur përputhshmërinë e diplomave me tregun e punës, si dhe për të lehtësuar procesin e praktikave profesionale të studentëve, si edhe punësimin e ardhshëm të tyre.

Kë këtë kuadër, UET zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to. Edhe periudha kohore e zhvillimit të Panairit të Punës, përkon pikërisht me fundin e vitit akademik për të krijuar sa më shumë mundësi për studentët në prag diplomimi.

ANALIZA SWOT

RVB mbyllet me “**Analizën përmbledhëse të RVB**” sipas metodës **SWOT** (**S**trengths-pikat e forta, **W**eaknesses- pikat e dobëta, **O**pportunities-mundësitë, **T**hreats-pengesat).

a. Pika të forta:

- 1) **Filozofia** e UET-it mbetet e fokusuar te **qasja analitike**. Misioni themelor synon aftësimin e studentëve në analizën e fenomeneve, ngjarjeve, koncepteve, ligjeve, politikave apo dukurive të tjera që hasen në zhvillimet e sotme në plan kombëtar e ndërkombëtar. UET-i synon të formojë e diplomojë një student që karakterizohet nga opinione të forta personale, aftësia e argumentimit mbi to dhe që zotëron informacionin e nevojshëm për të mbështetur opinionet që prezanton.
- 2) **Dokumentacioni i UET-it**: UET-i ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për funksionimin normal të tij në përputhje të kërkesave të Ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore. Veprimtaria akademike dhe ajo administrative në UET kontrollohet nga rregulla të qarta e të sakta, të shprehura në Statutin e UET, Rregulloren Bazë të UET, Broshurën e Dokumenteve Themelore të UET, etj. Këto dokumente, janë të depozituara në sistemin informatik të UET dhe të disponueshme elektronikisht nga tërë personeli akademik, administrativ si dhe studentët për çështje në interes të tyre.
- 3) **Rekrutimi dhe cilësia e stafit**. Nëpërmjet një personeli të kualifikuar mësimmhendës, drejtues, administrativ e mbështetës synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor ndaj studentëve nga të gjitha njësitë përbërëse. Rekrutimi i personelit akademik mbështetet mbi eksperiencën në mësimmhendësinë universitare, grada/titullit shkencor i kandidatit për pedagog dhe aktiviteti kërkimor shkencor e botues i tij.
- 4) **Qëndrueshmëria e personelit efektiv akademik**, rreth 93% e personelit efektiv të UET-it është i angazhuar prej dy ose më shumë vitesh në aktivitetin akademik të UET. Ky është një indikator i rëndësishëm që tregon se stafi i tanishëm i UET është më i përkushtuar, ka mundësi t’i qëndrojë më afër studentit, e kupton më mirë filozofinë, rregullat dhe procedurat e UET dhe ka të gjitha mundësitë të performojë më mirë se një vit më parë.
- 5) **Mësimmhendëria**. Qëllimi themelor në fushën e mësimmhendësisë është transmetimi tek studentët i një informacioni cilësor e bashkëkohor në të gjitha disiplinat mësimore e lëndët me karakter teorik e praktik, duke realizuar ciklin «informacion-njohuri-dije-aftësi». Qëllimi bazë i mësimmhendësisë është përgatitja e studentëve cilësorë, të aftë që të analizojnë dhe konkludojnë në mënyrë të pavarur, të debatojnë e marrin vendime të sakta, të orientohen shpejt përballë tërësisë së informacioneve dhe specifikave të sektorëve e degëve ku ata specializohen.
- 6) **Format e kontrollit të njohurive dhe vlerësimi i studenteve**. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Nota përfundimtare është rezultante e kombinimit të disa indikatorëve, me synim vlerësimin e vazhdueshëm për ta vendosur studentin në punë përgjatë të gjithë vitit. Vlerësimi i vazhdueshëm rrit nivelin e objektivitetit dhe transparencën në vlerësimin e studentit dhe ka natyrë stimuluese e inkurajuese.
- 7) **Kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik**. Në filozofinë e UET-it, kontrolli i brendshëm i performancës së stafit akademik është në funksion të cilësisë së mësimmhendësisë dhe synon arritjen e objektivave dhe standardeve bashkëkohore, që garantojnë transmetimin e dijeve dhe njohurive dhe zbatimin e metodologjisë bashkëkohore në formimin e studentëve. Kontrolli realizohet nëpërmjet vlerësimit

të çdo pedagogu dhe lënde nga vetë studentët; vetëvlerësimet të performancës nga çdo pedagog; vlerësimet prej eprorëve respektivë të punës së realizuar nga pedagogët dhe vlerësimet “administrativ” për aspekte të tilla si respektimi i orarit, niveli i shfrytëzimit të orës së mësimet, respektimi i afateve, korrektesa e çdo pedagogu në plotësimin e dokumentacionit përkatës etj.

- 8) **Kërkimi shkencor**, garanton pjesëmarrjen dhe aftësimin e pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor, angazhimin e tyre sa më të gjerë në botime e studime shkencore, organizimin periodik të konferencave shkencore nga çdo departament, botimin e katër revistave shkencore (“Polis”, “Jus & Justicia”, “Economicus”, “Sociological Analysis” (Studime sociologjike, në anglisht), botimin e monografive, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët, etj. Në kuadër të aktivitetit akademik që zhvillohet në Ciklin e Tretë, kërkimi shkencor është më i organizuar dhe i orientuar qartë në drejtime prioritare për UET dhe në funksion të zhvillimeve në vend. Të gjitha këto realizojnë vënien e rezultateve të kërkimit shkencor në shërbim të studentëve, procesit akademik dhe mbarë shoqërisë.
- 9) **Informaticimi i sistemit**, përfshirë veprimet në sekretari ndihmojnë për informimin e studentëve dhe kanë lehtësuar ngarkesën e madhe (veçanërisht në periudha të caktuara të vitit) të sekretarisë mësimore dhe të koordinatoreve të fakulteteve.
- 10) **Imazhi i mirë i UET-it në publik**. Sondazhe të organizuara nga vetë UET-i tregojnë se imazhi që ky institucion gëzon në publik është mjaft pozitiv. Ky imazh vjen si rezultat i punës cilësore në funksion të përmbushjes së misionit të UET-it.

b. Pika të dobëta:

- 1) Ende mungon një sistem (data base) i unifikuar që do të lehtësonte identifikimin e plagjiaturave në rastet e eseve të përgatitura nga studentët. Kjo çështje ka ngelur ende në dorën dhe vullnetin e pedagogut të lëndës. Janë vërejtur raste kur pedagogë të veçantë nuk i kanë dhënë rëndësinë e duhur këtij verifikimi.
- 2) Përfshirja e studentëve në vendim-marrje. Pavarësisht krijimit të hapësirave të shumta që mundësojnë pjesëmarrjen e studentëve në strukturat drejtuese të universitetit dhe/ose Fakultetit përkatës, të tilla si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, mbledhjet e departamenteve, etj., niveli i përfshirjes së studentëve në proceset vendimmarrëse që lidhen me çështjet e aktivitetit mësimor e akademik në UET është ende i ulët. Këtë vit u përdorën edhe disa forma të reja të vjeljes së mendimit të studentëve, si focus grupet, të cilat ishin frytdhënëse për t’u njohur me opinionet dhe sugjerimet e studentëve në lidhje me çfarë ata do të donin të përmirësonin, megjithatë fuqizimi i rolit të studentëve mbetet ende një objektiv për t’u arritur.
- 3) Përfshirja e studentëve, veçanërisht e atyre të ciklit të dytë dhe të tretë në veprimtarinë kërkimore – shkencore të UET lë për të dëshiruar.
- 4) Ende nuk është gjetur pika e duhur e takimit të kërkimit shkencor me mësimdhënien. Kërkimet shkencore të anëtarëve të stafit akademik të UET, pavarësisht se janë të lavdërueshme si për nga sasia edhe për nga cilësia nuk shihen gjithmonë me syrin e vënies së këtyre kërkimeve në funksion të mësimdhënies.
- 5) Pavarësisht nga puna e mirë e bërë nga UET – Press dhe punonjësit e bibliotekës UET, pasurimi i Bibliotekës së UET mbetet një ndër sfidat kryesore të këtij institucioni universitar. Kjo shfaqet veçanërisht në dy drejtime: (i) pasurimi me literaturë shkencore e akademike në gjuhën shqipe në përputhje me programet e lëndëve dhe (ii) shtimi i bibliografisë sidomos në mbështetje të programeve të studimit në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve.

c. Mundësitë:

- 1) Sondazhet tregojnë se UET-i gëzon një imazh pozitiv dhe të mirë në publik të cilin synon ta përforcojë dhe të ndërtojë mbi të të ardhmen e tij si një universitet elitare në vend.
- 2) Proceset integruese në të cilat është përfshirë vendi ynë, krijojnë mundësi të mëdha për zgjerimin e bashkëpunimit të UET-it me institucione brenda rajonit dhe më gjerë, në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor.
- 3) Kuadri ligjor aktual, bazuar në vullnetin politik përgjithësisht pozitiv ndaj institucioneve private të arsimit të lartë, përbën një mundësi të mirë që UET-i të konsolidohet dhe zhvillohet në të ardhmen.
- 4) Tendencë në rritje e besimit të publikut ndaj sektorit privat të arsimit të lartë përbën një mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të UET-it.

d. Pengesat:

- 1) Ndryshimet e shpeshta të kuadrit ligjor që ndikojnë negativisht veprimtarinë e shkollave të larta private përbëjnë një nga rreziqet kryesore të konsolidimit dhe jetëgjatësisë së UET-it.
- 2) Domosdoshmëria për diversifikimin e burimeve të financimit dhe mosmarrja e veprimeve konkrete në këtë drejtim, mbart rrezikun e asfiksimit të UET-it si institucionin i vetëfinancuar në tregun shqiptar.
- 3) Mosndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, në rajon e më gjerë, dhe mosreflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat, programet e lëndëve, dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e UET-it, rrezikon të vendosë në vështirësi rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të UET-it.
- 4) Zgjerimi horizontal dhe vertikal i UET nëpërmjet programeve të reja në të tri ciklet e studimit rrezikojnë cedimin e cilësisë së këtij universiteti. Këtyre sfidave iu duhet përgjigjur me konsolidimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe përballimit nga i gjithë stafi i UET i presioneve për nota dhe vlerësime të pamerituara.

Konkluzione

Me cilësinë e anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të Brendshëm mund të themi se Universiteti European i Tiranës, UET, është pozicionuar midis institucioneve më serioze të arsimit të lartë të vendit. Sidoqoftë, ky institucion ka nevojë të ndjekë përvojat më të mira në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të bashkëpunojë me institucione brenda dhe jashtë vendit, të bëhet më atraktiv për studiuesit e shquar në fushën e mësimdhënies e kërkimit shkencor brenda vendit, por jo vetëm, dhe të ndjekë nga më afër të gjitha ndryshimet ekonomike, sociale e kulturore në Shqipëri e në mbarë botën. Vetëm kështu UET-i do të jetë në gjendje të garantojë gjithmonë e më shumë cilësinë e shërbimeve që ofron.

Grupi i Vlerësimit të Brendshëm

1. Elda Papa, MA
2. Prof. Asoc. Dr. Tamara Luarasi
3. Prof. Asoc. Dr. Magdalena Bregasi
4. Prof. Asoc. Dr. Valier Peshkëpia
5. Marsel Cara, Doktorant
6. Marinela Seitaj, studente

Aneksi I – Struktura Organizative e UET

Aneksi II – Rregullorja e UET

Aneksi III – Programet e lëndëve (silabuset) e programit të studimit

Aneksi IV – Lista e programeve të studimit që UET ofron

Aneksi V – Lista e aktiviteteve të zhvilluara në UET

Aneksi VI – Projektet ku UET është partner